




UN Resolution
on Rights of
the Child 2019

Focus on Children without Parental Care

PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE PËR REZOLUTËN E OKB-së PËR TË DREJTAT E FËMIJËS NË VITIN 2019 ME FOKUS FËMIJËT PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE Nëntor 2019



Për	Të gjithë kolegët e Federatës së SOSFF-së të interesuar për Rezolutën e OKB-së 2019 për të Drejtat e Fëmijës
nga	Sofia Garcia Garcia, Përfaqësuese e OKB-së dhe Menaxhere e Projektit
data	26 nëntor 2019
Tema	Përmbledhje e informacioneve për Rezolutën e APOKB-së 2019 për të Drejtat e Fëmijës me fokus fëmijët pa përkujdesje prindërore

777 United Nations Plaza 3D
New York, NY, 10017
SHBA
Tel.: +1 917 376 4288
www.sos-childrensvillages.org

PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE PËR REZOLUTËN E OKB-së 2019 PËR TË DREJTAT E FËMIJËS NË VITIN 2019 ME FOKUS FËMIJËT PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE

Rreth këtij dokumenti

Ky dokument synon të mbështesë kolegët nëpër funksione dhe vendndodhje të ndryshme të federatës së SOS Fshatrave të Fëmijëve (SOS FF) për t'u njohur me Rezolutën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (Rezoluta e OKB-së për DF) të vitit 2019 e cila u miratua në 18 nëntor 2019 nga Komiteti i Tretë i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (APOKB) si(A/74/ L.21). Dokumenti do të mbështesë kolegët në leximin e rezolutës dhe që ta kuptojnë rëndësinë e saj, dhe më e rëndësishmja, parashtron disa ide fillestare se si pjesë të ndryshme të organizatës sonë mund të përdorin rezolutën për të përmbushur objektivat dhe angazhimet tona strategjike për fëmijët pa përkujdesje prindërore ose në rrezik për ta humbur atë. Ky dokument gjithashtu përfshin instrumente, propozime dhe udhëzime kryesore për komunikimet e jashtme dhe pozicionimin në ditën dhe ditët menjëherë pas miratimit të marrëveshjes ndërkombëtare nga APOKB-ja. Informacioni i destinuar vetëm për përdorim të brendshëm do të tregohet si i tillë.

- *Një version i parë i kësaj përmbledhje është shpërndarë së brendshmi në ditën e miratimit të rezolutës nga ana e Komitetit të Tretë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së më 18 nëntor 2019*
- 🔗 *Ky version (26.11.2019) përfshin këto pjesë të reja: II.C Analiza e përmbajtjes së rezolutës dhe VI.C Reagimi për t'u përdorur me partnerë të specializuar. Pjesa me lidhje me fotografitë dhe materialet pamore gjithashtu është përditësuar.*

Për përditësime të përmbajtjes së kësaj përmbledhje, materiale të reja dhe për pyetje të bëra shpesh, vizitoni [UN RoC 2019 Resolution Workspace](https://sosc.sharepoint.com/sites/WS_001360/SitePages/Welcome.aspx) në https://sosc.sharepoint.com/sites/WS_001360/SitePages/Welcome.aspx

¹ Ky raport është shtjelluar me bashkëpunimin e Daniela Araya (IOR LAAM) dhe Andro Dadiani (IOR EUCEB) të cilët në kohën e hartimit të tij kanë qenë të vendosur përkohësisht në zyrën e Nju Jorkut dhe kontribuojnë në detyra të ndryshme specifike të projektit të Rezolutës së OKB-së, si dhe me mbështetjen e Manjun Hao, praktikante në zyrën e Nju Jorkut

Indeksi

Indeksi	3
I. HISTORIKU I PËRGJITHSHËM TEKNIK	4
A. Çfarë është një Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së?	4
B. Të Drejtat e rezolutës për Fëmijën	4
C. Cilat janë implikimet e një Rezolute të OKB-së?.....	4
II. HISTORIKU SPECIFIK PËR DF 2019 FOKUSUAR NË FËMIJËT PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE	5
A. Cilat janë pjesët e ndryshme të Rezolutës për DF?	5
B. Përmbledhja e përmbajtjes thelbësore të rezolutës	7
C. Analiza e përmbajtjes së rezolutës (E RE)	9
III. SOS FSHATRAT E FËMIJËVE DHE REZOLUTA E OKB-së PËR DF 2019.....	14
A. Pse kemi investuar në miratimin e një rezolute me fokus në grupin tonë të synuar.....	14
B. Lidhja me Strategjinë 2030	15
IV. SI MUND TË NDIHMOJË SOS NË ZBATIMIN E REZOLUTËS DHE PËRDORIMIN E SAJ SI NJË MJET PËR SYNIMET E TIJ?	16
V. NË KË MUND TË LLOGARIS? SI MUND TË MËSOJË MË SHUMË? SI MUND T'I PLANIFIKOJË VEPRIMET SPECIFIKE?	17
VI. KOMUNIKIMI RRETH REZOLUTËS PËR DF 2019	18
A. Materiale për përdorim në media sociale dhe masive menjëherë pas miratimit.....	18
B. Fotografitë dhe pamjet.....	21
C. Reagimi për t'u përdorur me partnerë të specializuar (E RE).....	21
SHTOJCAT	23
Tabela 1- Cili është ndryshimi ndërmjet një Deklarate të OKB-së, Traktati të OKB-së, Rezolute të OKB-së dhe Udhëzimeve të OKB-së?.....	24
Tabela 2 - Si mund SOS-i t'i shfrytëzojë paragrafët kryesor?.....	25
Tabela 3 - Grafiku sipas funksionit.....	40
Tabela 4: Indeksi i Termeve	43

I. HISTORIKU I PËRGJITHSHËM TEKNIK

A. Çfarë është një Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së?

Një Rezolutë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara është një shprehje zyrtare e vullnetit të Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara (përfaqësimi i qeverisë në OKB). Rezoluta përfaqëson thjeshtë një marrëveshje politike dhe nuk ka implikime ligjore. Sidoqoftë, ajo përfshin rekomandime dhe angazhime nga qeveritë për të zbatuar politika dhe për të krijuar programe për arritjen e objektivave zhvillimore, për të planifikuar bashkëpunim dypalësh ose shumëpalësh për një çështje ose për të përmbushur të drejtat e zonave të ndryshme elektorale.

- ❖ Për më shumë informacion se çfarë është një Rezolutë e OKB-së dhe si ndryshon ajo nga dokumentet e tjera ndërkombëtare, ju lutemi shikoni tabelën 1 në Shtojcë.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së² është organi kryesor diskutues, politikbërës dhe përfaqësues i OKB-së. Duke u përbërë nga të gjitha 193 Anëtarët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ajo siguron një forum unik për diskutim shumëpalësh të spektrit të plotë të çështjeve ndërkombëtare, të përfshira në Kartën e OKB-së dhe Traktatet e të Drejtave të Njeriut. Ajo gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në procesin e vendosjes së standardeve dhe kodifikimin e së drejtës ndërkombëtare.

Asambleja e Përgjithshme ka gjashtë komitete kryesore dhe i cakton "**Komitetit të Tretë**" (*Social, Humanitar dhe Kulturor*) pikat e rendit të ditës në lidhje me një sërë çështjesh sociale, humanitare dhe çështje të të drejtave të njeriut që prekin njerëzit në të gjithë botën. Çdo vit, Komiteti i Tretë mbledhet nga tetori deri në nëntor për të diskutuar këto çështje dhe për të miratuar rezoluta që trajtojnë çështje të ndryshme që lidhen me avancimin e grave, mbrojtjen e fëmijëve, çështjet indigjene, trajtimin e refugjatëve, të drejtën e vetëvendosjes, etj. etj. Komiteti adreson gjithashtu çështje të rëndësishme të zhvillimit shoqëror si janë rinia, familja, plakja, personat me aftësi të kufizuara ose parandalimi i krimin. Mes këtyre, Komiteti lëshon çdo vit një rezolutë mbi "Të Drejtat e Fëmijës".

B. Të Drejtat e rezolutës për Fëmijën

Meqenëse Konventa për të Drejtat e Fëmijës ishte miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 20 nëntor 1989, Komiteti i Tretë i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ka miratuar një rezolutë vjetore, duke vlerësuar përparimin e arritur në përmbushjen e të drejtave të mbrojtura në Konventë. Rezoluta vlerëson progresin, dhe ri-konfirmon angazhimin për Konventën dhe traktatet e tjera të ndërlidhura me fëmijët, nxjerr në pah fushat e përqendrimit, rinovon mandatet e figurave kryesore për të drejtat e fëmijëve (siç janë Përfaqësuesit Specialë të Sekretarit të Përgjithshëm) dhe çdo vit përqendrohet në një "temë" ose grup fëmijësh për të cilët janë bërë angazhime specifike ose ku nevojitet përqendrim i mëtejshëm (këtë vit, 'fëmijët pa përkujdesje prindërore').

C. Cilat janë implikimet e një Rezolute të OKB-së?

Ndonëse nuk janë ligjërisht të detyrueshme, Rezolutat e APOKB-së-së bëhen një ligj i zakonshëm dhe referohen kur vlerësojnë progresin dhe angazhimet e vendeve. Temat e rezolutave për DF marren çdo

²<http://www.un.org/en/ga/>

katër vite në një "Rezolutë Omnibus", ku vendet anëtare vlerësojnë progresin e bërë në këto çështje dhe vlerësojnë fushat që kanë nevojë për përpjekje të mëtejshme.

II. HISTORIKU SPECIFIK PËR DF 2019 ME FOKUS NË FËMIJËT PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE

A. Cilat janë pjesët e ndryshme të Rezolutës për DF?

Preambula (PP)	Lista e Konventave dhe Kornizave, gjendja e të drejtave të fëmijëve, grupeve e veçanta të fëmijëve.
Paragrafët operacional (PO) (§1-35)	PO të përgjithshëm (§201-20) përcaktojnë veprimet që duhen ndërmarrë nga qeveritë Tema (§21-35): angazhimet specifike për përmbushjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të privuar nga përkujdesja prindërore
Pjesa përcjellëse (§36-41)	Përcakton veprimin për përcjelljen seancës së APOKB-së, rinovimin e mandateve, kërkesën për raporte, përcjelljen e temës së seancës

Preambula

Paragrafët parathënës zakonisht fillojnë me një folje kursive që përfundon në -tur (p.sh. Duke kujtuar...) dhe nuk numërohen.

Në pjesën parathënëse, shtetet anëtare paraqesin dhe **rekomandojnë kornizat përkatëse ndërkombëtare** si UDHR, CRC, konventa të tjera si CRPD, CEDAW dhe Konventat (ICCP, ICESC). Ata cekin dhe ri-zotohen në deklaratat përkatëse dhe planet e veprimit (Deklarata e Pekinit, Përshtatja Botërore për Fëmijët, Popujt Autoktonë, fëmijët emigrantë dhe refugjatë, çrrënjosjen e punës së fëmijëve dhe të tjerat). Pjesa parathënëse gjithashtu **thekson rëndësinë dhe punën e vlefshme të akterëve, strukturave dhe instrumenteve** për të drejtat e fëmijëve, siç janë avokati i popullit për fëmijët, familja, organet përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe njeh rolin e vlefshëm të shoqërisë civile dhe partneriteteve shumëpalëshe. Ata gjithashtu njohin dhe shprehin shqetësimin për **pasqyrën e përgjithshme të situatës së fëmijëve dhe kërcënimet kryesore për të drejtat e tyre** (varfëria, diskriminimi, ndryshimi i klimës, migracioni, përdorimi ushtarak i shkollave). **Nënvizojnë grupet e fëmijëve të drejtat e të cilëve janë veçanërisht në rrezik**, siç janë vajzat, fëmijët emigrantë, fëmijët me aftësi të kufizuara ose fëmijët pa kujdes prindëror.

Në rastin e Rezolutës për DF 2019, mund të gjejmë **24 paragrafë parathënës** (referuar si PP). Vlen të përmendet se dy paragrafët e fundit parathënës **përqendrohen në mënyrë eksplicite në njohjen e gjendjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore** dhe arsyet që çojnë në ndarjen e familjes, si dhe **njohjen e Udhëzimeve për Përkujdesje Alternativ të Fëmijëve** si një grup orientimesh për të ndihmuar informimin e politikës dhe praktikës për mbrojtjen e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror ose ata që rrezikojnë të jenë të tillë.

Për sa i përket **përdorimit**, këta paragrafë nuk mbajnë peshë zbatimi, megjithatë ata mund të shërbejnë si rrethanë dhe gjuhë për **dokumentet e politikave**, në **avokimin** tonë si një deklaratë e angazhimeve të tyre (qeveritare) dhe t'u tregojnë **donatorëve dhe partnerëve të tjerë** se çështja e fëmijëve pa

përkujdesje prindërore është deklaruar si një nga shqetësimet dhe fokuset kryesore për qeveritë në të gjithë botën.

Mund të përdoret gjithashtu për të promovuar dhe mbështetur më tej **përdorimin tonë të Udhëzimeve** për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve si një kornizë **për planifikim dhe programim**.

Pjesa operative

(Paragrafët 1-35 në DF 2019)

Kjo pjesë përcakton **veprimet që duhen ndërmarrë** nga qeveritë. Prandaj, kjo pjesë operacionalizon rezolutën. Paragrafët operativ fillojnë me foljet në kohën e tanishme (p.sh., nxit, vendos, kërkon).

Pjesa operationale përmban paragrafët që lidhen me temën, në këtë rast **paragrafët mbi veprimet për të përmbushur të drejtat e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror ose në rrezik që të privohen në këtë mënyrë**. Ato përfshihen në **paragrafët 21 deri 35**. Brenda këtyre paragrafëve, **§34 dhe §35 përmbajnë veprime specifike** dhe kërkojnë nga vendet anëtare të **parandalojnë ndarjen e familjes** dhe t'ju ofrojnë atyre fëmijëve që nuk mund të mbesin në kujdesin e prindërve të tyre mbrojtje dhe t'ju sigurojnë mirëqenien e tyre, ndër të tjera, duke siguruar një gamë opsionesh të **përkujdesjes alternative**, duke renditur veprimet se si ta bëjnë këtë.

- ❖ Në pjesën II B të këtij dokumenti dhe në tabelat 2 dhe 3 si shtojcë, mund të gjeni një analizë të hollësishme të përmbajtjes së paragrafëve më të rëndësishëm operacional dhe ideve fillestare se si ato mund të përdoren për të kontribuar më mirë në përmirësimin e situatës së fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror dhe/ose për objektivat tona organizative.

Përcjellja

(paragrafët 36-41 në DF 2019)

Në pjesën vijuese, shtetet anëtare **rinovojnë mandatet** e akterëve kryesorë për të drejtat e fëmijëve, siç është Përfaqësuesi Special kundër Dhunës ndaj Fëmijëve, **kërkojnë raporte** dhe dokumente për seancat pasuese të Komitetit të Tretë, siç është Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për gjendjen e të drejtave të fëmijës, caktojnë temën e **fokusimit për vitin pasardhës (në rastin e këtij viti Të Drejtat e Fëmijës dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm)** dhe ftojnë Kryesuesin e Komisionit për të Drejtat e Fëmijës për t'u përfshirë në seancën e vitit të ardhshëm të APOKB-së.

Vlen të përmendet se rezoluta e këtij viti në një mënyrë të paparë, bën thirrje për miratimin e një rezolute të re jo në vitin pasues (seanca e 75-të e APOKB-së), por pas (seancës së 76-të të APOKB-së) e cila është referuar si **dy-vjeçarizim** i Rezolutës për DF (nëse keni nevojë për më shumë informacion mbi këtë aspekt specifik, ju lutemi kontaktoni Përfaqësuesen e OKB-së).

B. Përmbledhja e përmbajtjes thelbësore të rezolutës

Në Rezolutën për DF 2019, shtetet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara paraqesin dhe **rekomandojnë kornizat përkatëse ndërkombëtare** dhe planet e veprimit, duke përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës, duke riafirmuar parimet e përgjithshme të Konventës, duke përfshirë interesin më të mirë të fëmijës, mos diskriminimi dhe pjesëmarrjen si kornizë për të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët. Në mesin e këtyre teksteve dhe kornizave ndërkombëtare, shtetet anëtare kujtojnë Rezolutën duke mirëpritur **Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve** si një grup orientimesh për të ndihmuar informimin e politikës dhe praktikës për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve pa përkujdesje prindërore ose që rrezikojnë ta humbin atë.

Qeveritë **theksojnë gjithashtu rëndësinë dhe punën e vlefshme të akterëve, strukturave dhe instrumenteve për të drejtat e fëmijëve**, përfshirë kontributet e shoqërisë civile. Ç'është më e rëndësishmja, ata njohin gjithashtu punën e Përfaqësuesve Specialë të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) siç është PSSP-ja për fëmijë në konflikt të armatosur, mandati i të cilëve vazhdohet edhe për një vit, ose PSSP-ja për Dhunën kundër Fëmijëve që vendet anëtare i inkurajojnë të vazhdojnë të zbatojnë rekomandimet e përcaktuara në studimin e saj për t'i dhënë fund të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve.

Përmes rezolutës, bashkësia ndërkombëtare gjithashtu njeh dhe shpreh shqetësimin për **gjendjen e fëmijëve dhe kërcënimet kryesore për të drejtat e tyre në** mënyrë specifike duke theksuar varfërinë, diskriminimin, ndryshimin e klimës, migracionin, përdorimin ushtarak të shkollave dhe shkeljen e së drejtës së arsimit për fëmijët në konflikt të armatosur. **Nxjerr në pah grupet e fëmijëve të drejtat e të cilëve janë veçanërisht në rrezik**, siç janë vajzat, fëmijët emigrantë dhe refugjatë, fëmijët me aftësi të kufizuara ose fëmijët pa kujdes prindëror.

Në temën e fokusimit në fëmijët pa përkujdesje prindërore, shtetet anëtare riafirmojnë që **një fëmijë duhet të rritet në një mjedis familjar** për zhvillimin e plotë të personalitetit të ti (§21) dhe shprehen qartë se ata që nuk mund të lejohen të qëndrojnë në familjet e tyre të kenë të **drejtë për mbrojtje dhe ndihmë të veçantë nga shteti** (§21). Teksti i rezolutës cek **rastet në të cilat ndarja nga një autoritet kompetent mund të jetë i nevojshëm**, siç është abuzimi ose dhuna (§24) si dhe ato **raste në të cilat një fëmijë nuk duhet të detyrohet kurrë të heqë dorë nga marrëdhëniet e tij familjare ose të largohet** nga familja e tij, duke përmendur në mënyrë të qartë varfërinë ose mungesën e qasjes në kujdes, migracion, arsim ose shërbime shëndetësore, të cilat duhet të interpretohen si një sinjal për nevojën për të siguruar mbështetje për familjen, (28, 30, 32). Fëmijët të cilët, për çfarëdo arsye, janë në kontakt me ligjin ose sistemin e drejtësisë për të mitur, duhet t'u referohen shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve e jo sistemit të drejtësisë (§29).

Shtetet anëtare kërkojnë të sigurojnë një **koordinim dhe financim më të mirë të sistemeve dhe mekanizmave bazuar në bashkëpunimin shumë-sektorial** (§31) dhe të përmirësojnë kapacitetin e të gjithë akterëve që punojnë me fëmijët përmes **trajnitimit të tyre për të drejtat e fëmijëve duke marrë parasysh Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve**.

Ndër **veprimet që vendet anëtare angazhohen të ndërmarrin për të parandaluar ndarjen e familjes** (§34), është ajo se shtetet anëtare angazhohen për të **rritur investimet** (§34 a), ndajnë **buxhete**, fuqizojnë **ligjet** dhe zbatojnë **programe** dhe sigurojnë burime të nevojshme për të mbështetur familjet dhe komunitetet për t'u kujdesur në mënyrë efektive për fëmijët e tyre (§34 b), duke marrë një **qasje sistematike** për parandalimin e ndarjes së familjes.

Si shumica e masave dhe grupeve më efektive për t'u fokusuar, shtetet anëtare njohin rëndësinë dhe **zotohen për t'u përqendruar në: uljen e varfërisë** përmes transferimeve të parave të gatshme, punësimit dhe sistemeve të ndjeshme gjinore ndaj mbrojtjes sociale, mes tjerash (§34 g, j), parandalimin e **dhunës** (§34 c), mbështetjen për familjet me fëmijë me **aftësi të kufizuara** (§34 i) dhe **nënat adoleshente** (§34 j) dhe **promovimin e të qenit prind pozitiv** dhe ndihmës së familjeve dhe ofruesve të përkujdesjes përmes arsimit dhe aftësimit.

Shtetet anëtare zotohen të sigurojnë **parimin e domosdoshmërisë**, d.m.th., se largimi i një fëmije nga familja e tij është një **masë e mjetit të fundit** dhe përipiqen **për ri-integrim të shpejtë** nëse adresohen ose zgjidhen arsyet e ndarjes, dhe kur janë në të mirë të interesit të fëmijës (§34 e).

Në mënyrë që të përmbushin siç duhet parimet e domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë, qeveritë angazhohen të vendosin **procedura mbrojtëse** të rrepta dhe sistematike të mbrojtjes gjyqësore dhe administrative dhe të sigurojnë që të gjitha vendimet të merren **rast pas rasti**, nga **profesionistë të kualifikuar në interesin më të mirë të fëmijës** si konsideratë parësore dhe në përputhje me **Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve** (§34 k, l)

Për fëmijët pa kujdes prindëror, Asambleja e Përgjithshme u kërkon shteteve anëtare të ndërmarrin veprime për të siguruar (a35a):

- **gëzimin e plotë të të drejtave të tyre të njeriut duke** zbatuar kornizat ndërkombëtare, forcimin e legjislacionit kombëtar (a35 a), trajnimin e akterëve përkatës për të drejtat e fëmijës dhe Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve (a35 a, e) - dhe sigurimin e llogaridhënies për shkelje (§35 i)
- **sigurimin e një varg mundësish të përkujdesjes alternative** që është gjithëpërfshirëse, përfshirë kujdesin invalidor, të rregulluar siç duhet (licencimi, regjistrimi ...) dhe monitorimin e rregullt të cilësisë së kujdesit, statusin e fëmijës dhe rrethanat për vendosje në të gjitha mjediset e përkujdesjes alternative (§35 c)
- mbledhjen më të mirë të të dhënave për të mbyllur boshllëqet e të dhënave dhe për të siguruar që cilësia e të dhënave udhëzon në politikë bërje (§35d)
- caktimin e prioriteteve të opsioneve të kujdesit cilësor mbi institucionalizimin përmes reformimit të legjislacionit, ndarjes së buxheteve, miratimit të planeve kombëtare të veprimit, ri-kanalizimit të burimeve, akterëve të trajnimit (§35, f)
- **mbrojtjen e tyre duke krijuar dhe zhvilluar mekanizma për fëmijët në përkujdesje alternative për të raportuar dhunën ose shqetësimet tjera përcjellëse** (§35 k)

Rezoluta gjithashtu vendos vëmendje të veçantë për fëmijët pa përkujdesje prindërore të cilët përjetojnë **forma të ndërmjetme të diskriminimit** siç janë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë emigrantë dhe refugjatë (§35 o-s), fëmijët me aftësi të kufizuara, vajzat (§35 m), fëmijët në rrugë (§35 n) ose viktimat e trafikimit të fëmijëve (§35 t), duke siguruar që kujdesi që ata marrin të përshtatet me nevojat dhe

rrethanat e tyre specifike.

Në një paragraf të pashembullt (§35 l), Shtetet Anëtare angazhohen të sigurojnë që fëmijët dhe adoleshentët në përkujdesje alternative të marrin mbështetje në **përgatitjen për kalimin në jetën e pavarur** dhe të kenë qasje në **shërbimet e përkujdesjes**, në përputhje me **Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve**.

Aspektet tjera të rëndësishme përfshijnë mirëpritjen e përkujtimeve të **30 vjetorit** të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe marrëveshjes për **temën e Rezolutës së ardhshme për DF**, e cila do të negociohet në vitin 2021, që edhe janë edhe **Qëllimet e të Drejtave të Fëmijës dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm**.

- ❖ *Për të gjetur se ku shfaqet përmbajtja specifike, mund të gjeni një listë temash dhe paragrafësh përkatës të tyre në tabelën 4 të Shtojcës. Për një reagim të jashtëm me qëllime mediatike, ju lutemi shikoni pjesën VI të këtij dokumenti.*

C. Analiza e përmbajtjes së rezolutës(E RE)

Çfarë arrin rezoluta e OKB-së?

Sjell çështjet e kujdesit të fëmijëve në diskutimin gjithëpërfshirës të të drejtave të fëmijëve

Rezoluta e OKB-së për të drejtat e fëmijës (DF) është një "rifreskues" i angazhimeve për të cilat vendet anëtare të OKB-së u nënshkruan nën RDF e OKB-së dhe traktatet tjera ndërkombëtare. Duke u përqendruar te fëmijët pa përkujdesjen prindërore, rezoluta krijon një lidhje të fortë ndërmjet të drejtave të fëmijëve dhe kujdesit për fëmijët, duke iu bërë thirrje qeverive të punojnë në kujdesin e fëmijëve si një element thelbësor për të mbështetur të drejtat e fëmijëve. Ajo hap mundësi për rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë, nxit shtytjen politike për të ndërmarrë hapa të guximshëm në adresimin e sfidave në kujdesin e fëmijëve dhe krijon mundësi për të hyrë në më shumë burime financiare (veçanërisht ato grante të dedikuara për përmbushjen e të drejtave kryesore të njeriut dhe të fëmijëve). Rezoluta zhvendos perceptimin e çështjeve të kujdesit për fëmijë nga prizmi i kufizuar i punës sociale dhe "bamirësia" në fushën e të drejtave të njeriut.

Lidh diskutimin e kujdesit dhe nevojat e grupit tonë të synuar me diskutimin e përgjithshëm të zhvillimit(përfshirë SDG-të)

Humbja e kujdesit prindëror dhe nevoja për mbështetje të familjeve nuk paraqiten si çështje të pavarura. Ato janë të ndërlidhura me dështimet në politikat e përgjithshme të zhvillimit të shteteve anëtare. Politikat e synuara të zhvillimit në mënyrë të duhur në fusha të tilla si: shëndetësia (SDG3), arsimi (SDG4) mbrojtja sociale dhe ulja e varfërisë (SDG1), barazia gjinore (SDG5), punët e mira (SDG8) dhe madje edhe ndryshimi klimatik dhe ulja e rrezikut nga katastrofat (SDG13) do të kontribuonin drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës dhe perspektivës së fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdesje prindërore dhe do të parandalonin ndarjen e familjes. Rezoluta njeh ndikimin e varfërisë në zona më të gjera të zhvillimit të vendeve. Ajo shkon përtej prizmit socio-ekonomik të varfërisë dhe nënvizon ndërlidhjen e brendshme ndërmjet zhdukjes së varfërisë, zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke ofruar një kontekstualizim dhe inkuadrim të nevojshëm për rëndësinë dhe kontributin e punës për këta fëmijë.

Lartëson Udhëzimet për përkujdesjen alternative të fëmijëve si standardi që duhet të ndiqet kur sigurohet dhe vendoset mirëqenia e fëmijëve dhe sistemet e kujdesit ndaj fëmijëve.

Rezoluta bën referenca për të gjitha traktatet dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare që i përkasin dhe mundësojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Mes tjerash, ajo bën disa referime të Udhëzimeve për Përkujdesjen Alternative të Fëmijëve, duke iu referuar atyre si një "grup orientimesh për të ndihmuar informimin e politikës dhe praktikës për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror ose të cilët kanë rrezik të jenë të tillë" dhe duke njohur përparimin e arritur që nga miratimi i këtyre udhëzimeve. Ndërsa gjuha formale e [rezolutës së OKB-së](#) e miratuar 10 vjet më parë ishte: "mirëpresin Udhëzimet", formulimi i përdorur për të referuar Udhëzimet në këtë rezolutë të fundit është: "miratimi i Udhëzimeve". Përveç gjuhës më të fortë, ajo gjithashtu rrit rëndësinë e udhëzimeve duke u bërë thirrje praktike vendeve anëtare të zbatojnë veprimet e tyre në përputhje me to ose duke i marrë parasysh ato.

Lidh humbjen e kujdesit prindëror me shkeljet e tjera të të drejtave të fëmijëve dhe bën të qarta lidhjet ndërmjet humbjes së kujdesit dhe cenueshmërive të tjera

Rezoluta pranon se fëmijët pa përkujdesje prindërore janë më të prekshëm se të tjerët për të përjetuar dhunë, abuzim, neglizhencë, shfrytëzim dhe përjashtim, duke hapur kështu derën për të shtuar se mbrojtja e tyre ka nevojë për më shumë përqendrim, mbështetje dhe investim. Duke e nxjerrë nga raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Situatën mbi të Drejtat e Fëmijës, rezoluta përmend grupe specifike të fëmijëve që posaçërisht rrezikojnë të humbasin kujdesin prindëror, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara, vajzat ose fëmijët emigrantë, duke vendosur një lidhje të qartë ndërmjet komuniteteve që punojnë, dhe veprimet e bëra, për të adresuar ato çështje.

Ekziston një thirrje e qartë se zgjidhja duhet të jetë sistematike dhe duhet të ketë investime në qasje gjithëpërfshirëse, të koordinuara, me burime të duhura dhe shumë-sektoriale

Në adresimin e sfidave me të cilat përballen fëmijët, shteteve u kërkohet të forcojnë përpjekjet për të reformuar sistemin e tyre kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve, kujdesit ndaj fëmijëve dhe mirëqenies sociale përmes një bashkëpunimi të koordinuar mirë shumë-sektorial ndërmjet autoriteteve të mirëqenies së fëmijëve, arsimit, shëndetësisë dhe drejtësisë. Përpjekjet e tilla duhet të përfshijnë gjithashtu trajnimin e këtyre profesionistëve në Udhëzime, së bashku me ndërtimin e aftësive të tyre në fusha të tjera përkatëse që kanë të bëjnë me kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve. Rezoluta përcakton në mënyrë të qartë këta sektorë duke njohur kështu që kujdesi cilësor i fëmijëve dhe mbrojtja efektive e fëmijëve kurrë nuk interpretohet në sektorin shoqëror dhe duhet të shihet si një detyrë thelbësore e të gjithë këtyre akterëve dhe sektorëve të tjerë të përfshirë.

Qeveritë njohin rëndësinë e investimit dhe organizimit të sistemeve mbrojtëse

Kjo do të siguronte domosdoshmërinë dhe përshtatshmërinë e zgjidhjeve për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje ose përkujdesje alternative në përputhje me Udhëzimet. Mekanizmat e tillë duhet të sigurojnë që në proceset që prekin jetën e tyre fëmijët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe që një pjesëmarrje e tillë të organizohet në atë mënyrë që të sigurojë përfaqësimin e vërtetë të dëshirave dhe mendimeve të tyre.

Parandalimi i ndarjes së panevojshme ka nevojë për përqendrim të mëtutjeshëm për të zbatuar parimet e zgjidhjes së fundit dhe domosdoshmërisë. Varfëria nuk duhet të jetë arsyeja e vetme për

ndarjen e familjes

Duke pranuar që shumë fëmijë që mund të jenë me prindërit e tyre janë akoma të ndarë në mënyrë të panevojshme, shteteve anëtare u kërkohet t'ju japin përparësi investimeve në shërbimet për të mbështetur familjet dhe forcuar komunitetet. Shtetet duhet të sigurojnë vendosjen e programeve dhe politikave me buxhete të përshtatshme dhe fuqi punëtore për të adresuar shkaqet thelbësore të ndarjes. Politikat dhe programet e mbrojtjes sociale duhet të jenë të ndjeshme ndaj fëmijëve, gjinive dhe aftësive të kufizuara dhe të synojnë përmirësimin e aftësive pozitive të prindërve, së bashku me pajisjen e familjeve me njohuri dhe aftësi për të përballuar varfërinë dhe përjashtimin social.

Rezoluta riafirmon që asnjë fëmijë nuk duhet të ndahet nga prindërit vetëm për shkak të varfërisë së familjes ose kundër vullnetit të një fëmije, përveç nëse vlerësohet nga profesionistët e mandatuar se një gjë e tillë është në interesin e tij më të mirë. Largimi duhet të përdoret vetëm si mjeti i fundit dhe duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës nga profesionistët.

Në planifikimin e kujdesit për fëmijën, ri-integrimi me prindërit duhet të konsiderohet si një mundësi kryesore, nëse shqyrtimi i detyrueshëm periodik i rastit konsideron se të gjitha arsyet e largimit janë zgjidhur ose janë zhdukur.

Ekziston një nevojë e qartë për transformimin e sistemeve të kujdesit për fëmijët. Duhet të krijohet një gamë e opsioneve alternative të kujdesit cilësor që sigurojnë parimin e përshtatshmërisë. Një madhësi nuk i përshtatet të gjithëve.

Për rastet kur fëmijët nuk mund të qëndrojnë pranë prindërve të tyre, shteteve u kërkohet që të sigurojnë disponueshmëri të një game cilësore përfshirëse të aftësisë së kufizuar të shërbimeve të përkujdesje alternative për emergjencë, kujdes afatshkurtër dhe afatgjatë, në përputhje me udhëzimet. Këto shërbime duhet të rregullohen nga shtetet dhe të mbikëqyren në përputhje me standardet përkatëse, licencimin, përgjegjshmërinë dhe kërkesat e mbrojtjes së fëmijëve.

Fuqia punëtore e angazhuar nga këto shërbime dhe profesionistë të sektorëve të ndërlidhur (drejtësi, shëndetësi, arsim, çështje të brendshme) duhet të kalojnë një trajnim sistematik adekuat për të drejtat e fëmijëve, Udhëzimet dhe procedurat e tjera specifike të vendit.

Institucionalizimi nuk është kurrë në interesin më të mirë të fëmijës.

Rezoluta njeh dëmet e kujdesit institucional në zhvillimin e fëmijëve dhe në mënyrë të hapur dekurajon përdorimin e saj për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët emigrantë, fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë apo fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Njohje e qartë e nevojës për më shumë burime dhe efikasitet

Rezoluta u kërkon qeverive t'ju japin përparësi investimeve në mbrojtjen e fëmijëve, shërbimeve sociale për fëmijët dhe përkujdesje alternative. Shteteve Anëtare ju bëhet thirrje të miratojnë kornizat e nevojshme rregullative që sigurojnë të drejtën e fëmijëve në shërbimet e nevojshme të ndihmës brenda komuniteteve të tyre të pajisura me buxhet të mjaftueshëm dhe burime njerëzore të kualifikuara. Në përpjekjet për të reformuar sistemin e mirëqenies së fëmijëve, bëhet thirrje burimet të ridrejtohen nga kujdesi institucional drejt shërbimeve të parandalimit të ndarjes dhe shërbimeve të kujdesit të bazuar në familje dhe në komunitet, duke zëvendësuar kështu në mënyrë progresive institucionalizimin me përkujdesje alternative cilësore.

Përkujdesja alternative duhet të mbikëqyret dhe monitorohet për të siguruar përgjegjshmëri dhe mbrojtje

Sistemet e mirëqenies së fëmijëve duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve, ndërtimin e kapaciteteve të stafit të përfshirë drejtpërdrejt në kujdesin për fëmijët dhe mekanizmat për reagim të shpejtë ndaj shkeljeve dhe abuzimeve në të gjitha mjediset e kujdesit, me fokus të veçantë për të siguruar llogaridhënien e atyre përgjegjës. Mekanizmat e monitorimit, zbatimit dhe drejtësisë për mbrojtjen e fëmijëve, të cilët duhet të sillen në vëmendjen e të gjithë fëmijëve në përkujdesje, të jenë konfidencial dhe miqësor ndaj fëmijëve dhe njihen në rezolutë si thelbësore për mbrojtjen efektive të fëmijëve.

Apelon për nevojën e të dhënave më të mira dhe më gjithëpërfshirëse dhe lidhjen me zhvillimin e politikave të shëndosha kombëtare. Njohja e hendekut ekzistues të të dhënave që duhet të plotësohet

Mungesa e të dhënave për fëmijët pa përkujdesje prindërore në të gjitha mjediset mbetet të jetë një sfidë adresimi e cila është thelbësore për aftësinë e shteteve për të planifikuar investime, buxhete, për të hartuar politika dhe programe të mbështetura në baza të shëndosha dhe të besueshme.

Njohja e qartë e lidhjes ndërmjet investimeve në fëmijëri dhe suksesit në moshën madhore dhe rëndësia e mbështetjes së kalimit në moshën madhore për kthim të qëndrueshëm të investimeve

Rezoluta u kërkon shteteve anëtare të marrin masa për të mbështetur fëmijët në kalimin nga kujdesi në jetën e pavarur që i qasen çështjes në mënyrë tërësore, duke krijuar një narrativë pozitive dhe shumë të nevojshme për vazhdimësinë e jetës. Ajo thekson fushat kryesore të përqendrimit për mbrojtjen e të rinjve përfshirë arsimimin dhe trajnimin e vazhdueshëm, qasjen në strehim, punësim të dobishëm dhe mbështetje psikosociale.

Zotimi për të vazhduar mbështetjen e figurave kryesore të të drejtave të fëmijëve

Mandatet e Përfaqësuesve Specialë për Dhunën ndaj Fëmijëve (znj. Najat Maalla M'jid), Fëmijët dhe Konflikti i Armatosur (znj. Virginia Gamba) dhe PS i Këshillit të të Drejtave të Njeriut për shitjen dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve (znj. Maud de Boer-Buquicchio)ishin vazhduar. Atyre dhe Kryesuesit të Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve iu kërkua që të vazhdojnë punën e tyre dhe të raportojnë për progresin në OKB.

[Lojtarët përçarës dhe çështjet kontestuese](#)

Minimi i të drejtave të fëmijëve dhe instrumenteve të mbrojtjes, dëmtimi i multilateralizmit

Disa shtete anëtare të fuqishme, siç janë Rusia dhe SHBA-të demonstrojnë qartë përpjekjet për të minuar instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve. Këto përpjekje përfaqësohen nga ndryshimet e propozuara në projektet e rezolutës në procesin e bisedimeve që synojnë të zvogëlojnë forcën e gjuhës që i referohet KDR-së ose Udhëzimeve dhe të fshijnë çdo referencë për nevojën për zbatimin e standardeve të përcaktuara nga këto dokumente. Shtetet anëtare dhe grupet e shteteve anëtare si BE, GRULAC ose Grupi i Afrikës (me disa përjashtime) megjithatë, rezistojnë ndaj përpjekjeve të tilla dhe mbrojtjen forcimin e gjuhës dhe referencave për këto traktate të rëndësishme ndërkombëtare dhe standarde kornizë. **** Ju lutemi vini re se këto informata janë vetëm për përdorim të brendshëm dhe ne ju rekomandojmë të mos t'ua bëni me gisht shteteve anëtare të veçanta në komunikimet tona.**

Heqja e Rezolutës së të Drejtave të Fëmijës të vitit të ardhshëm

Qeveritë vendosën të bëjnë thirrje që rezoluta e ardhshme të hartohet gjatë seancës së 76-të të Asamblesë së Përgjithshme të saj, pra në vitin 2021 (në vend të vitit 2020, pra seancës së 75-të). Hapja e derës për të bërë Rezolutën për të Drejtat e Fëmijës formon një ushtrim vjetor për një aktivitet dy vjeçar. Arsyetimi i këtij vendimi është që të optimizojë ngarkesën e punës së Komitetit të Tretë dhe vendeve anëtare që marrin pjesë në negociata. Sidoqoftë, kjo zvogëlon qartë përparësinë e vendosur mbi të drejtat e fëmijëve në agjendën e shteteve anëtare, pasi shumë rezoluta të tjera brenda mandatit të Komitetit të Tretë do të vazhdojnë miratohen për çdo vit. SOS do të përpiqet të shtojë në maksimum mundësinë indirekte për të maksimizuar faktin që qeveritë janë zotuar të vendosin fokusin në sigurimin e zbatimit, por gjithashtu do të përpiqen, në koordinim me partnerë të tjerë në Nju Jork të kthejnë trendin dhe të bëjnë që Rezoluta për të Drejtat e Fëmijës të thirret përsëri për çdo vit.

Konfuzioni dhe kuptimi i ndryshëm i termit institucionalizim

Gjatë negociatave, disa shtete anëtare (nëpër rajone dhe grupe) thërrisnin shumë fuqishëm për të "përfunduar institucionalizimin" ndërsa të tjerat thërrisnin për të "përfunduar institucionalizimin e panevojshëm". Diskutimi dhe argumentet e përdorura, zbuluan se mosmarrëveshja nuk bazohej në disa shtete anëtare duke menduar se institucionalizimi është i mirë apo i nevojshëm, por se ka kuptime të ndryshme se çfarë është kujdesi institucional. Për disa institucione që përfshijnë shtëpitë e grupeve të vogla dhe kujdesin rezidencial, për të cilat argumentojnë, janë në situata shumë të kufizuara dhe specifike të domosdoshme ose një mundësi e përshtatshme. Për të tjerat, institucionet gjithmonë i referohen lehtësive në shkallë të gjerë me karakteristika institucionale dhe kështu nuk janë kurrë të nevojshme ose në interesin më të mirë të fëmijës. Përmes këshillave dhe thirrjeve për t'iu referuar udhëzimeve për përkufizime dhe për të gjetur ndonjë bazë të përbashkët për të gjetur konsensus, situata u zgjidh. Ne e transformuam këtë situatë në një mundësi për të nxitur mirëkuptimin e disa aktorëve kryesorë. Sidoqoftë, nevojitet akoma më shumë ndërgjegjësim mbi Direktivat dhe qartësi dhe konsensus mbi terminologjinë.

Edukimi për të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues (DSHSR). Disa shtete anëtare kundërshtojnë me forcë angazhimin për të promovuar një edukim të tillë dhe në mënyrë aktive ulin gjuhën që u bën thirrje shteteve të veprojnë në këtë drejtim.

Të drejtat e fëmijës kundrejt "të drejtave" të familjes. Disa qeveri përpiqen të përfaqësojnë prindërit si një grup me të drejta (në vend të përgjegjësisë) dhe si autoriteti i vetëm kryesor për të përcaktuar interesin më të mirë të fëmijës në procesin e edukimit të tyre. Ndërsa prindërit dhe familjet kanë rolin kryesor në edukimin e fëmijëve, përcaktimi i interesit të tyre më të mirë është sfera e autoriteteve ligjore me mandat dhe të kualifikuara, veçanërisht në rastet e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi i prindërve.

Sigurimi i të drejtave të fëmijëve për pjesëmarrje në çështje që prekin jetën e tyre. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë është dëshmuar të jetë shumë polemike. Edhe këtu disa qeveri bëjnë thirrje që prindërit të jenë mjeti kryesor për sigurimin e pjesëmarrjes së fëmijëve, madje edhe kur vërtetohet se diskrecioni i vetëm i prindërve për sigurimin e pjesëmarrjes për të shërbyer interesin më të mirë të fëmijës, do të ishte kundër-produktiv për qëllimin e pjesëmarrjes.

Fëmijët emigrantë shihen ende si të ndryshëm në të drejtat e tyre. Akoma shihen nga disa shtete anëtare si të ndryshëm - në radhë të dytë kur bëhet fjalë për angazhimet për të respektuar të

drejtat e tyre. Meqenëse pozicionet e vendeve specifike ose grupeve të vendeve informohen kryesisht nga realitetet pragmatike dhe nga një përparësi e argumenteve të sigurisë kombëtare për përmbushjen e të drejtave të këtyre fëmijëve, gjuha e rezolutës që ka të bëjë me fëmijët emigrantë të pashoqëruar dhe të ndarë është e dobët dhe e paqartë. Paraburgimi ende shihet si zgjidhja e fundit për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe jo diçka që duhet të eliminohet dhe që cenon interesin më të mirë të fëmijës.

Mandati i ekspertit të pavarur për fëmijë të privuar nga liria (z. Manfred Novak) nuk u vazhdua me këtë rezolutë, përkundër propozimit të një shteti anëtar. Ky është një tregues i qartë i mungesës së interesit të shteteve anëtare për të trajtuar çështjen kryesore të privimit të lirisë së fëmijëve dhe për të zotuar fonde të mëtejshme për të.

III. SOS FSHATRAT E FËMIJËVE DHE REZOLUTA E OKB-së PËR DF 2019

A. Pse kemi investuar në miratimin e një rezolute me fokus në grupin tonë të synuar

(KENI PARASYSH: kjo pjesë është vetëm për informim të brendshëm)

Çdo vit, një Rezolutë për të Drejtat e Fëmijës negociohet dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. SOS Fshatrat e Fëmijëve identifikoi se rezoluta vjetore nuk u ishte drejtuar kurrë fëmijëve pa përkujdesje prindërore, kështu që ne vendosëm të avokojmë dhe këshillojmë qeveritë që Rezoluta 2019 për DF të përqendrohet në pjesën e saj tematike mbi të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore. Synimet e jashtme të ndjekura përfshijnë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe krijimin e njohurive për grupin tonë të synuar, dhe çështjet që ndikojnë në jetën e tyre, ndërmjet zyrtarëve kryesorë të qeverisë dhe vendimmarrësve në arenat ndërkombëtare dhe kombëtare.
- Forcimin e rrëfimeve për lidhjen ndërmjet të drejtave të përgjithshme të fëmijëve dhe agjendave të zhvillimit me nevojat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik për ta humbur atë.
- Arritjen e një tekst ligjor ambicioz dhe gjithëpërfshirës për të shtyrë më tej qeveritë të përmbushin të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe ata që rrezikojnë ta humbin atë dhe të nxisin një njohje dhe urgjencë të nevojave të grupit tonë të synuar, duke adresuar mungesën e vëmendjes politike në arenën ndërkombëtare për këtë grup fëmijësh.
- Ofrimin e mjeteve të fuqishme ligjore për KK dhe Zyrat Rajonale tona për të mbështetur dhe forcuar përpjekjet e tyre kombëtare për avokim për sisteme dhe investime më të mira të kujdesit, duke i mbajtur qeveritë përgjegjëse për këtë dhe duke mbështetur programatikisht ato në ofrimin e shërbimeve.
- Krijimin e një "gjuhe të pajtuar" që do të përdoret për përpjekjet e mëtutjeshme të avokimit në arenën ndërkombëtare.
(Gjuha e pajtuar është zakonisht më e lehtë për t'u përfshirë në rezolutat e ardhshme dhe dokumentet zyrtare të OKB-së.)
- Forcimin e pozicionit të SOS-it si drejtues dhe ekspert në përkujdesje alternative dhe parandalimin e ndarjes së familjes.
- Forcimin dhe kultivimin e marrëdhënieve me qeveritë dhe vendimmarrësit e tjerë kryesorë në

fushat e të drejtave të fëmijëve dhe zhvillimit.

Bazuar në analizën dhe objektivat e cekura më sipër, dhe duke u bazuar në momentumin e krijuar nga përvjetori i 10-të i Udhëzimeve për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve në 2019, Zyra e Nju Jorkut ka filluar një projekt për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me këtë çështje dhe në mënyrë bilaterale avokon me përfaqësitë qeveritare në Selinë e OKB-së në Nju Jork për të propozuar dhe përzgjedhur temën e fokusit gjatë seancës 2018 për të Rezolutën për të Drejtat e Fëmijëve 2019.

Pasi të kenë arritur që kjo të ndodhë, shoqata rajonale dhe disa anëtare, si dhe akterët kryesorë të ON-ve, këshilluan përfaqësuesit e qeverisë për përmbajtjen që rezoluta mund të përfshijë, në mënyrë që ajo të jetë ambicioze dhe e zbatueshme. Një seri rekomandimesh të aspekteve që mund të përfshihen, [dokumenti teknik për rezolutën e OKB-së](#), u krijua në bashkëpunim dhe konsultim me akterët e gjerët federatës dhe u ndanë përmes takimeve bilaterale me përfaqësuesit e qeverive në OKB të më shumë se 70 vendeve. U formua një grup partnerësh të shoqërisë civile në përkujdesjen alternative dhe të drejtave të komunitetit të fëmijëve që përfshinte UNICEF-in, Better Care Network, Hope and Homes, Save the Children dhe Lumos, dhe një dokument me çështjet kryesore të avokimit, i mbështetur nga 250 organizata (përfshirë donatorë si Fondacioni Oak ose Fondacioni Optimus) u hartua gjithashtu nga SOS Fshatrat e Fëmijëve.

- ❖ Një vlerësim i projektit do të jetë në dispozicion nga 6 dhjetori, duke përfshirë afatin kohor të projektit, aktivitetet që janë në dispozicion, sfidat dhe pikat e forta, si dhe mësimet e rëndësishme. Ai mund të gjendet në [UN RoC 2019 Resolution Workspace](#) ose i kërkohet Përfaqësueses së OKB-së në Nju Jork, Sofia García García sofia.garcia-garcia@sos-kd.org

B. Lidhja me Strategjinë 2030

- 🌍 Në Strategjinë 2030, federata planifikon të krijojë risi në përkujdesjen alternative (SI1.) Duke iu bërë thirrje shtetet anëtare të ofrojnë një gamë të gjerë opsionesh të përkujdesjes alternative, rezoluta hap një mundësi unike për të gjetur partnerë dhe fonde për të përtërirë programet tona dhe për të zgjeruar dhe shumëfishuar shërbimet tona.
- 🌍 Njëlloj në SI 2, federata njeht rëndësinë e programeve të forcimit të familjes. Rezoluta përshkruan një sërë veprimesh që qeveritë angazhohen të ndërmarrin për të parandaluar ndarjen e familjes; SOS mund të krijoj partneritet me qeveritë për t'i ndihmuar ato të zbatojnë sipërmarrje të tilla në një mënyrë lokale të rëndësishme.
- 🌍 Në një paragraf të paparë, Rezoluta e OKB-së nënvizon nevojat e adoleshentëve dhe të rinjve që kalojnë jashtë sistemit të kujdesit. Ajo e njeht se sa është e nevojshme mbështetja, udhëzimi dhe përgatitja adekuate për një jetë të pavarur, duke përfshirë qasjen në punësim, arsim, trajnim, strehim, mbështetje psikologjike, si dhe shërbime pas përkujdesjes. SI 3 ndan të njëjtat synime dhe mund të bazohet në nevojën e qeverive për njohuri dhe praktika të mira për t'i shërbyer të rinjve në përkujdesje duke promovuar programe si Youth Can, Youth Links dhe një mori praktikash dhe programesh të shkëlqyera mbi pjesëmarrjen e rinisë dhe fuqizimin e drejtuar nga Mas jonë në të gjithë globin.
- 🌍 Rezoluta për DF 2019 përcakton një varg zotimesh që qeveritë janë të gatshme të bëjnë për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Përpjekjet tona për avokim mund të kontribuojnë për t'i ndihmuar ata të

përdorin fjalët e tyre në praktikë, duke avokuar në përafrimin e legjislacionit kombëtar dhe politikat publike me rezolutën dhe duke i mbajtur përgjegjës qeveritë dhe aktorët e tjerë kryesorë.

Rezoluta cakton konturat e diskutimit të përkujdesjes alternative dhe ngre rëndësinë e saj në fushën dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijës. Duke qenë udhëheqës në procesin e hartimit, SOS mund të mobilizojë partnerë të ndryshëm për zbatimin e saj dhe të ndërgjegjësojë publikun e gjerë për të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, duke nxitur interesin e nevojshëm për shfaqjen e një lëvizjeje gjithëpërfshirëse (SI5)

Në SI7, organizata vendos një objektiv për të siguruar qëndrueshmërinë e operacioneve tona. Rezoluta e OKB-së thekson rëndësinë e burimeve financiare kombëtare dhe ndërkombëtare që duhet të dedikohen për funksionimin e duhur të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve alternative të kujdesit, si dhe mbështetjen e familjes. SOS mund të reflektojë në këtë momentum për të hyrë në një grup të burimeve të ndryshme të financimit, përfshirë subvencionet qeveritare, agjencitë bashkëpunuese dhe fondacionet e mëdha.

IV. SI MUND TË NDIHMOJË SOS NË ZBATIMIN E REZOLUTËS DHE PËRDORIMIN E SAJ SI NJË MJET PËR SYNIMET E TIJ?

Legjislacioni ndërkombëtar përcakton standardin dhe fokusin e qeverive, agjencive të OKB-së, donatorëve dhe akterëve të tjerë që nxisin veprime në nivelin kombëtar. Rezoluta e OKB-së për DF 2019 përcakton angazhimet e qeverisë në fushat kryesore të punës dhe fokusit tonë.

Për shembull, një rezolutë e OKB-së mund të mbështesë fuqimisht kolegët që bëjnë mbledhje fondesh me donatorë institucional për të bërë lidhjen ndërmjet grupit tonë të synuar dhe temave kryesore të zhvillimit, për të cilat dedikohen shuma të mëdha të fondeve tradicionale. Disa shembuj të tillë përfshijnë dimensionin gjinor të dhunës, humbjen e kujdesit për shkak të situatave humanitare ose katastrofave të lidhura me klimën, nevojën për të zhdukur varfërinë (SDG1) dhe për të siguruar punë të mira (SDG8) për familjet për të parandaluar ndarjen e panevojshme ose thirrjet për të forcuar sistemet për mbrojtjen e fëmijëve.

Rezoluta përfshin disa thirrje për të përdorur Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve si referencë për trajnimin e profesionistëve të kujdesit dhe të tjerëve në të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore. Ne mund ta përdorim këtë përkushtim për të pozicionuar organizatën tonë si një ekspert kryesor në Udhëzimet dhe t'i bindim qeveritë për rëndësinë e ndarjes së fondeve për këto trajnime; kjo jo vetëm që do të sjellë fonde për organizatën tonë, por gjithashtu do të përmirësojë marrëdhëniet dhe imazhin tonë me qeveritë në të gjitha nivelet, duke na ndihmuar të bëhemi një kontribuues kryesor për funksionimin e mirë të sistemit të kujdesit dhe ndërtimin e markës sonë jo vetëm si ofrues të shërbimit, por edhe si akter i një sistemi të gjerëtë bazuar në të drejta.

Paragrafë të tillë si ai që thekson nevojën për të mbështetur adoleshentët në kalimin e tyre në moshën madhore dhe thirrja për të siguruar shërbime të përkujdesjes për të gjithë të rinjtë, krijojnë një nevojë për praktika dhe njohuri të mira që SOS mund t'i plotësojë shumë mirë përmes pozicionimit dhe ndërtimit të partneritetit, duke ngritur kështu profilin tonë organizativ si partner kryesor për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve, agjendën e rinisë dhe kontributin në mirëfunksionimin e sistemeve dhe shoqërive.

- ❖ Në tabelën 2 (të bashkangjitur më poshtë), i kemi nënvizuar paragrafët më të rëndësishëm për punën tonë dhe grupin e synuar. Ajo sqaron se çfarë janë paragrafët, si dhe disa ide fillestare se si zotimet e qeverisë të deklaruara në to mund të përmirësojnë fuqinë e avokimit tonë, na ndihmon në ngritjen e çështjes me donatorët për të rritur fondet në dispozicion për programet për t'i shërbyer grupit tonë të synuar, të akordojmë gjuhën që përdorim në hulumtimet tona, politikat dhe komunikimet e jashtme dhe të krijojmë dhe planifikojmë kontributin tonë programatik për të përmbushur të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore në një mënyrë narrative dhe strategjike të kontekstualizuar. Tabela 3 ofron njohuri të ngjashme, të organizuara nga zona funksionale dhe vendndodhja. Tabelat 2 dhe 3 janë draftet dhe një ide fillestare për të mbështetur kolegët në të gjithë federatën të mendojnë se si do të përdorin rezolutën dhe të parashikojnë se si mund të ndihmojnë në përmbushjen e objektivave të tyre. Ne ju inkurajojmë të ndani me ne idetë tuaja se si SOS-i mund të mbështesë qeveritë dhe palët e tjera të interesit të arrijnë zotimet e përcaktuara në tekst. Ne pastaj mund t'i shtojmë ato në tabelat tona dhe të ndajmë bagazhin e njohurive me të gjithë kolegët.

V. NË KË MUND TË LLOGARIS? SI MUND TË MËSOJË MË SHUMË? SI MUND T'Ë PLANIFIKOJË VEPRIMET SPECIFIKE?

Kontakti: Ne jemi këtu për të ndihmuar! Për çdo pyetje që lidhet me rezolutën, punën që kemi bërë për ta bërë atë të ndodhë ose si të maksimizojmë ndikimin e saj, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni me Sofia Garcia, Përfaqësuese e OKB-së në Nju Jork dhe Shefe e Partneriteteve Strategjike në Sofia.Garcia-Garcia@sos-kd.org.

Ne i inkurajojmë të gjithë kolegët të zhvillojnë diskutime të brendshme rreth rezolutës së OKB-së dhe të mendojnë se si ky mjet për zhvillimin e fondeve, komunikimin, avokatinë, partneritetet dhe të tjerat mund t'ju shërbejë më së miri në arritjen e synimeve tuaja. Zbatimi i Rezolutës së OKB-së dhe të drejtat e fëmijës është përgjegjësi e qeverive dhe, me një planifikim të duhur, kjo mund të përdoret në shumë si një mundësi për federatën tonë.

Punëtoritë: Për t'ju mbështetur me këtë planifikim, ne kemi organizuar një seri seminaresh ballë për ballë gjatë muajve të parë të vitit 2020. Këto do të mbahen në rajone të ndryshme dhe me fokuse të ndryshme funksionale. Qëllimi i këtyre punëtorive do të jetë që t'ju mbështesin në njohjen me rezolutën dhe procesin e saj dhe, më e rëndësishmja, të mbështesni kolegët e ndryshëm për të reflektuar se si mund ta përdorni këtë instrument ndërkombëtar për të arritur synimet tuaja. Nëse jeni të interesuar, ju lutemi kontaktoni Daniela Araya në Daniela.araya@sos-kd.org.

Seminaret përmes internetit: Nëse keni pyetje specifike ose planifikoni veprime para se të organizohet një punëtori ku mund të merrni pjesë, ju lutemi na kontaktoni. Ne gjithashtu do të organizojmë seminare online përmes internetit për P&P dhe shkëmbimin e pilot praktikave dhe atyre më të mira.

Hapësira e punës: Datat dhe vendet për secilën punëtori do të shpallen në [hapësirën tonë të punës](#), kështu që ju lutemi shikoni kohë pas kohe për atë dhe për më shumë informacione.

Materialet: do të nxirret një version i lehtë për t'u përdorur i rezolutës dhe materiale të tjera siç është pjesa e pyetjeve më të shpeshta (PPSH) në hapësirën tonë të punës do të prodhohen në muajt e ardhshëm. Nëse ka ndonjë gjë që mendoni se do t'ju ndihmojë juve dhe kolegëve tjerë në përdorimin e rezolutës, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.

Menaxhimi i njohurive: Do të botojmë rregullisht artikuj me mësim dhe aktivitete të kaluara ose të ardhshme rreth rezolutës. Dhe ne do të donim të ndërtonim pjesën tonë të lajmeve së bashku. **Ju lutemi na njoftoni për çdo veprimtari, ide ose përvojë** që keni kur përdorni rezolutë për planifikim, mbledhje fondesh, komunikim ose avokim gjatë përdorimit të rezolutës. Ne do të postojmë artikuj në pjesën e lajmeve për të siguruar që të gjithë mund të mësojmë nga njëri-tjetri në të gjithë federatën dhe të maksimizojmë efikasitetin.

VI. KOMUNIKIMI RRETH REZOLUTËS PËR DF 2019

A. Materiale për përdorim në media sociale dhe mjetet të informacionit menjëherë pas miratimit

Mediat sociale

- 🐦 @Sos_fshatrat mirëpret angazhimin e shteteve anëtare të @OKB-së për #fëmijët pa përkujdesje prindërore me miratimin e tyre të një #Rezolute të OKB-së të përkushtuar për të siguruar mbështetje për familjet për të parandaluar ndarjen dhe përkujdesjen alternative cilësore për të gjithë fëmijët #Inob #WorldChildrensDay #iseeyou # CRC30
- 🐦 Sot shënohet një moment historik në punën tonë: @OKB-ja sapo miratoi një rezolutë për të drejtat e #fëmijëve pa përkujdesje prindërore. #UNresolution #WorldChildrensDay #iseeyou # CRC30
- 🐦 Urime për #APOKB për forcimin e përpjekjeve të tyre për t'i bërë të dukshëm fëmijët pa përkujdesjen prindërore & për të siguruar zgjidhje cilësore #alternative #UNresolution #WorldChildrensDay #iseeyou # CRC30
- 🐦 Ne po festojmë 30 vjetorin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, 10 vjetorin e Udhëzimeve të OKB-së për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve dhe sot mirëpresim një #Rezolutë të re të OKB-së për #fëmijët pa përkujdesje prindërore
- 🐦 Të dhënat duhet të informojnë politikën: #Rezoluta e re e OKB-së për fëmijët pa përkujdesje prindërore bën thirrje për të dhëna të ndara për gjendjen e #fëmijëve që jetojnë pa prindërit e tyre. @UNstats #iseeyou #CRC30
- 🐦 Qeveritë duhet të investojnë në #Mbështetje për familjet për të parandaluar ndarjen e panevojshme të # fëmijëve nga #prindërit e tyre sipas #rezolutës së re të OKB-së @ilo_newyork @soc_protection të miratuar rishtazi.
- 🐦 Nuk ka asnjë madhësi që i përshtatet të gjithave: Çdo fëmijë ka nevoja të ndryshme që kërkojnë lloje të ndryshme të #Përkujdesjes alternative, konfirmon #Rezoluta e re e OKB-së #WorldChildrensDay #iseeyou
- 🐦 Të rinjtë që largohen nga #Përkujdesja alternative duhet të përgatiten herët dhe të marrin gjithë mbështetjen e nevojshme, konfirmon #Rezoluta e re e OKB-së #WorldChildrensDay #iseeyou
- 🐦 Një forcë pune e trajnuar sociale mbron të drejtën e të rinjve që lënë #Përkujdesjen alternative për të ecur në shtigjet e tyre të jetës, konfirmon #Rezoluta e re e OKB-së #iseeyou # CRC30 #humanrights
- 🐦 #APOKB-ja rrit përpjekjet për t'u bërë thirrje qeverive të sigurojnë #mekanizma rregullues dhe zgjidhje cilësore të #përkujdesjes alternative #Rezoluta e OKB-së # CRC30 #bestinterestsofthechild #humanrights
- 🐦 @Sos_fshatrat mirëpret angazhimin e @OKB-së për #fëmijët pa përkujdesje prindërore: Komiteti i



SOS CHILDREN'S
VILLAGES
INTERNATIONAL

KOMUNIKIM/INFORMIM I BREND SHËM

tretë sot miratoi një #Rezolutë të OKB-së # CRC30 të re #bestinterestsofthechild
#soschildrensvillages

*Deklarata e reagimit për publikun e gjerë***Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miraton rezolutën për të Drejtat e Fëmijës me përkushtime domethënëse për fëmijët pa përkujdesje prindërore**

Më 18 nëntor 2019, Komiteti i Tretë i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së përfundoi negociatat dhe miratoi rezolutën e tij vjetore për të Drejtat e Fëmijës ([A/C.3 /74/L.21/Rev.1](#)). Këtë vit, rezoluta përqendrohet tek fëmijët pa përkujdesje prindërore - një nga popullatat më të rrezikuara në botë.

Në rezolutë, vendet anëtare të OKB-së shprehin shqetësimin për cenueshmërinë e veçantë të miliona fëmijëve në të gjithë globin për shkak të mungesës së një mbështetje të duhur për familjet në rrezik dhe një sërë opsionesh të kujdesit cilësor për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror. Rezoluta gjithashtu përshkruan një seri veprimesh dhe angazhimesh për të përmirësuar situatën dhe për të përmbushur të drejtat e këtij grupi të fëmijëve.

Vendet anëtare ripohojnë zotimin e tyre për të zbatuar veprime kyçe sistematike, siç është trajnimi i autoriteteve që punojnë me fëmijë në përdorimin e Udhëzimeve për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve. Ato bëjnë thirrje për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave për të informuar politikën dhe programimin për këtë grup fëmijësh. Ato gjithashtu pranojnë se një gamë e opsioneve të kujdesit cilësor janë të nevojshme për të përmbushur parimet e domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së vendosjes së kujdesit dhe për të shmangur institucionalizimin, duke siguruar që çdo fëmijë mund të pajiset me një zgjidhje të individualizuar të kujdesit në interesin e tij më të mirë.

Përveç gjuhës së miratuar në rezolutë, vendet anëtare ripohuan dokumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve si Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve në këtë mënyrë e shohin pranimin se cenueshmëritë e humta shpesh kryqëzohen dhe shkaktojnë ndarjen e familjes dhe vlerësojnë angazhimin për të marrë një qasje gjithëpërfshirëse për të siguruar përmbushjen dhe mbrojtjen e të drejtave të çdo fëmije. Një seri veprimesh drejt forcimit të aftësisë së prindërve për t'u kujdesur për fëmijët e tyre dhe për të përmirësuar situatën ekonomike dhe sociale të familjeve është një fokus i mirëpritur i rezolutës pasi që do të sigurojë se përkujdesja alternative është gjithmonë një masë e zgjidhjes së fundit.

Përmes pranisë së saj në 136 shtete dhe territore dhe me përvojën e saj 70 vjeçare për t'iu shërbyer fëmijëve pa përkujdesje prindërore, SOS Fshatrat e Fëmijëve janë të gatshme të mbështesin OKB-në dhe shtetet anëtare të saj në zbatimin e kësaj rezolute në vitet e ardhshme dhe pret angazhimin e tyre të vazhdueshëm, si me fjalë ashtu edhe vepra, për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Shënime për redaktorët:

Teksti i plotë i rezolutës së OKB-së për fëmijët pa përkujdesje prindërore është në dispozicion këtu ([A/C.3/74/L.21/Rev.1](#)) dhe është planifikuar të miratohet zyrtarisht në dhjetor.

Statusi vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm "Statusi për Konventën për të Drejtat e Fëmijës" 2019, duke u fokusuar te fëmijët pa përkujdesje prindërore është në dispozicion [këtu](#).

Për më shumë informacion mbi llojet e përkujdesjes alternative cilësore, klikoni [këtu](#).

Citate për përdorim të përgjithshëm

“Ne mirëpresim rezolutën e re të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës si një moment historik për komunitetin e kujdesit. Fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik për të humbur kujdesin prindëror shpesh janë lënë pas dore. Fëmijëria e shumë fëmijëve është shkurtuar për shkak të mungesës së kujdesit dhe mbrojtjes. Zbatimi i rezolutës së re të OKB-së është një domosdoshmëri që qeveritë të zbatojnë të gjitha të drejtat e fëmijëve,” tha Presidenti i SOS Fshatrave të Fëmijëve Siddhartha Kaul.

“Përmes kësaj marrëveshje ndërkombëtare, qeveritë nga e gjithë bota njohin situatën e rëndë në të cilën rriten shumë fëmijë, me të drejtat e tyre të shkelura dhe zhvillimin e potencialit të tyre të komprometuar. Por më e rëndësishmja, ata përcaktojnë një seri zgjidhjesh dhe angazhimesh për të vendosur mekanizmat, investimet dhe sistemet për të përmbushur dhe mbrojtur të drejtat dhe për të përmbushur nevojat e mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore,” tha Përfaqësuesja e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Organizatë e Kombeve të Bashkuara, Sofia Garcia Garcia.

“Në këtë rezolutë për të Drejtat e Fëmijës, qeveritë janë zotuar të vendosin programe, politika dhe investime për të përmbushur më mirë të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, duke siguruar që profesionistët dhe sistemet që i shërbejnë ata ta bëjnë këtë nga një qasje e bazuar në të drejta dhe pjesëmarrje,” tha Përfaqësuesja e SOS e Fshatrave të Fëmijëve në Kombet e Bashkuara, Sofia Garcia Garcia.

“Me miratimin e kësaj rezolute, qeveritë kanë ndërtuar momentum për të përmirësuar situatën e miliona familjeve dhe fëmijëve në mbarë botën. SOS Fshatrat e Fëmijëve, si një lider në bashkësinë ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve dhe një ofrues i përkujdesjes me përvojë prej dekadash, janë të gatshëm të mbështesin qeveritë dhe autoritetet e tjera në përkthimin e rezolutës në hapa dhe veprime konkrete në vendin e tyre, në mënyrë që çdo fëmijë të rritet me kujdes cilësor,” tha Presidenti i SOS Fshatrave të Fëmijëve, Siddhartha Kaul.

B. Fotografitë dhe pamjet

Në këtë link mund të gjeni foto që lidhen me projektin e rezolutës së OKB-së, pamjet dhe GIF si dhe shablloni për dokumente të jashtme dhe prezantime të PP

https://soscv.sharepoint.com/:f:/r/sites/WS_001360/Public%20Documents/1911%20UN%20Res%20RoC%20Visuals?csf=1&e=avWes5

C. Reagimi për t'u përdorur me partnerë të specializuar (E RE)

Narrativi i përfshirë në këtë pjesë mund të përdoret si deklarata ose fletëpalosje për anëtarët e ditur të qeverisë, parlamentarët, ministritë ose autoritetet përkatëse lokale, si dhe të përfshijë në konferencat për media të specializuara, për donatorët, anëtarët e Bordit, etj.

- ❖ Për një version të gatshëm për ta shtypur, ju lutemi shkarkoni [PDF-in këtu](#). Për dokument në Word për të shtuar një adresë kontakti, ju lutemi [klikoni këtu](#).

Në dhjetor 2019, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një Rezolutë për të Drejtat e Fëmijës (DF) me fokus fëmijët pa përkujdesje prindërore. Në 30 vjetorin e miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), rezoluta tregon përkushtimin global qeveritar për të zbatuar politikat sistematike me interesat më të mira të fëmijës si parim udhëzues. SOS Fshatrat e Fëmijëve e mirëpresin këtë moment historik dhe identifikojnë çështjet e mëposhtme si vijimësi kryesore nga rezoluta:

Ngre lart çështjet e kujdesit të fëmijëve në diskutimin gjithëpërfshirës të të drejtave të fëmijëve

Duke u fokusuar te fëmijët pa përkujdesje prindërore, rezoluta krijon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet kujdesit ndaj fëmijës dhe të drejtave të fëmijës. Në këtë rast, sigurimi i kujdesit cilësor është një mjet kryesor për të përmbushur dhe mbrojtur të drejtat e fëmijës.

Lidh fëmijët pa përkujdesje prindërore me diskutimin e përgjithshme të zhvillimit

Politikat e synuara të zhvillimit në mënyrë të duhur në fushat siç janë: shëndetësia (SDG3), arsimi (SDG4), mbrojtja sociale dhe ulja e varfërisë (SDG1, SDG10), barazia gjinore (SDG5), puna e mirë (SDG8), ndryshimi klimatik dhe ulja e rrezikut nga katastrofat (SDG13) kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdesje prindërore dhe parandalimin e ndarjes së familjeve. Prandaj, politikat për fëmijë dhe adoleshentë pa përkujdesje prindërore dhe parandalimin e ndarjes së familjeve përbëjnë zbatimin e Agjendës së vitit 2030.

Lartëson Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve si standard për ndryshimin dhe zbatimin sistematik të politikave

Rezoluta bën referenca në traktate ndërkombëtare dhe instrumente ligjore që i përkasin dhe mundësojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Mes tyre, ajo i referohet Udhëzimeve për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve si një "varg orientimesh për të ndihmuar informimin e politikave dhe praktikave për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror ose të cilët rrezikojnë të jenë të tillë".

Lidh humbjen e përkujdesjes prindërore me shkeljet kryesore të të drejtave të fëmijëve dhe tregon natyrën e ndërlidhur të humbjes së përkujdesjes prindërore dhe cenueshmërive tjera

Rezoluta pranon që fëmijët pa përkujdesje prindërore janë më të prekshëm se të tjerët për të përjetuar dhunë, abuzim, neglizhencë, shfrytëzim dhe përjashtim, duke kërkuar kështu përqendrim në mbrojtje, mbështetje dhe investime për fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Gjithashtu, duke nxjerrë nga raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Situatën e të Drejtave e Fëmijës 2019, rezoluta përmend grupe specifike të fëmijëve, të cilët posaçërisht rrezikojnë të humbasin kujdesin cilësor, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara, vajzat, ose fëmijët emigrantë dhe refugjatët. Identifikimi i grupeve specifike kërkon që të përshtatet mbështetja dhe mbrojtja e ofruar.

Bën thirrje për zgjidhje sistematike dhe koordinim gjithëpërfshirës, të koordinuar, me burime të duhura dhe shumë-sektoriale

Në adresimin e sfidave me të cilat përballen fëmijët, shteteve u kërkohet të forcojnë përpjekjet për të reformuar sistemin kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve, kujdesit për fëmijët dhe mirëqenien sociale duke siguruar një bashkëpunim të koordinuar mirë dhe shumë-sektorial ndërmjet mirëqenies së fëmijëve, arsimit, shëndetësisë dhe autoriteteve të drejtësisë. Përpjekje të tilla përfshijnë gjithashtu trajnimin e profesionistëve në sektorë të shprehur në mënyrë specifike në Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve. Kujdesi cilësor i fëmijëve dhe mbrojtja efektive e fëmijëve nuk duhet të kufizohen në sektorin shoqëror dhe duhet të përfshijnë një gamë të gjerë të karakterëve.

Njeh rëndësinë e investimit dhe organizimit të duhur të sistemeve mbrojtëse

Vendimet duhet të merren nga autoritetet kompetente pasi të informohen për vlerësimin e plotë të situatës individuale të fëmijës. Mekanizmat e tillë duhet të sigurojnë që në proceset që prekin jetën e tyre fëmijët mund të marrin pjesë dhe të dëgjohen, në një mënyrë që garanton përfaqësimin e vërtetë të dëshirave dhe mendimeve të tyre.

Ripohon se varfëria nuk duhet të jetë arsyeja e vetme për largimin e një fëmije dhe ndarja e familjes duhet të jetë mëjti i fundit

Shteteve anëtare u kërkohet t'ju japin përparësi investimeve në shërbime për të mbështetur familjet dhe forcuar komunitetet. Qeveritë angazhohen të vendosin programe dhe politika me buxhete të përshtatshme dhe të trajnojnë fuqinë punëtore për të adresuar shkaqet thelbësore të ndarjes.

Rezoluta gjithashtu konfirmon që asnjë fëmijë nuk duhet të ndahet nga familja vetëm për shkak të varfërisë.

Largimi duhet të përdoret vetëm si mjet i fundit, vetëm kur është në interesin më të mirë të fëmijës, bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës nga profesionisti, dhe duhet të rivlerësohet rregullisht. Për më tepër, në planifikimin e kujdesit për fëmijën, duhet të synohet në ri-integrimin me prindërit.

Bën thirrje për një sërë opsionesh të përkujdesjes alternative cilësore për të siguruar që parimi i përshtatshmërisë është përmbushur

Një madhësi nuk i përshtatet të gjithave. Për fëmijët që nuk mund të qëndrojnë me prindërit e tyre, shteteve u kërkohet të sigurojnë disponueshmëri të një game cilësore dhe gjithëpërfshirëse të aftësisë së kufizuar të shërbimeve të përkujdesjes alternative për emergjencë, kujdes afatshkurtër dhe afatgjatë, në përputhje me Udhëzimet. Fuqia punëtore e angazhuar nga këto shërbime dhe profesionistët e sektorëve të ndërlidhur (drejtësi, shëndetësi, arsim, çështje të brendshme) duhet të marrin një trajnim adekuat sistematik.

Rezoluta njeh dëmet e kujdesit institucional në zhvillimin e fëmijëve dhe dekurajon hapur përdorimin e saj pasi ajo kurrë nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.

Bën thirrje për mbikëqyrje sistematike dhe monitorim të kushteve të përkujdesjes alternative për të siguruar përgjegjshmëri

Sistemet e mirëqenies së fëmijëve duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut për çështje që lidhen me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve, ndërtimin e kapaciteteve të personelit të përfshirë drejtpërdrejt me fëmijën, dhe mekanizmat për reagim të shpejtë ndaj shkeljeve dhe abuzimeve në të gjitha mjediset e kujdesit, me një fokus të veçantë në sigurimin e llogaridhënies së atyre që janë përgjegjës. Mekanizmat e monitorimit, zbatimit dhe drejtësisë për ruajtjen e fëmijëve duhet të jenë konfidencial dhe miqësor ndaj fëmijëve.

Njeh boshllëqet ekzistuese të të dhënave dhe bën thirrje për të dhëna të ndara në cilësi për hartimin e politikave të bazuara në prova

Mungesa e të dhënave për fëmijët pa përkujdesje prindërore në të gjitha mjediset mbetet një sfidë. Adresimi i boshllëqeve të të dhënave është thelbësore për aftësinë e shteteve për të planifikuar investime, buxhete, zhvillimin e politikave dhe programeve të mbështetura në baza të shëndosha dhe të besueshme.

E njeh qartë lidhjen e fortë ndërmjet investimeve në fëmijëri dhe suksesit në moshën e rritur

Rezoluta nxit qeveritë të marrin masa për të mbështetur fëmijët që kalojnë nga përkujdesja alternative në jetën e pavarur në një qasje tërësore. Ajo thekson fushat kryesore të fokusimit për mbrojtjen e të rinjve përfshirë arsimimin dhe trajnimin e vazhdueshëm, qasjen në strehim, punësim të

dobishëm dhe mbështetje psikosociale.

SOS Fshatrat e Fëmijëve janë të gatshëm të mbështesin qeveritë në zbatimin e Rezolutës për të Drejtat e Fëmijëve 2019 duke shkëmbyer ekspertizën tonë programatike për kujdesin e fëmijëve. Ne gjithashtu do të krijojmë dhe lidhim partneritete për të rritur ndërgjegjësimin për temat kryesore të mbrojtjes së fëmijëve dhe për t'u angazhuar me ekspertë dhe vendimmarrës për të nxitur mirëkuptimin e përbashkët dhe të qartë të zgjidhjeve të përkujdesjes alternative nga vendimmarrësit në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.

SHTOJCAT

Tabela 1: Cili është ndryshimi ndërmjet një Deklarate të OKB-së, Traktati të OKB-së dhe një Rezolute të OKB-së?

Tabela 2: Përdorimet sipas paragrafit

Tabela 3: Përdorimet sipas funksionit

Tabela 4: Indeksi i termave

Tabela 5: Lista e dokumenteve kryesore

Tabela 1- Cili është ndryshimi ndërmjet një Deklarate të OKB-së, Traktati të OKB-së, Rezolute të OKB-së dhe Udhëzimeve të OKB-së?

Elementi	Traktati	Rezoluta	Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve
Vendet e përfshira	Ndërmjet dy vendeve si minimum, për të gjitha vendet në botë si maksimum. Disa vende mund të kenë rezerva në zbatim.	E miratuar me konsensus ose votim nga të gjitha 193 vendet anëtare të OKB-së Disa vende mund të kenë rezerva (që mbahen në procesverbal)	Udhëzimet mund të përdoren nga të gjitha vendet, por ato nuk u votuan ose dakorduan përmes mekanizmave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
Procedura e miratimit	Miratuar me nënshkrim dhe ratifikim	Miratuar me konsensus ose votim	Shprehja e vetme për Udhëzimeve nga vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara ishte t'i "mirëpresë" ato përmes një Rezolute të Komitetit të Tretë. Ato nuk përbëjnë vetë një rezolutë.
Implikimet ligjore	Juridikisht detyruese	Nuk është juridikisht detyruese, një rezolutë është një shprehje zyrtare e mendimit për vullnetin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.	Udhëzimet përcaktojnë orientime të dëshirueshme për politikë dhe praktikë për qeveritë, por ato nuk kanë implikime ligjore ose politike, sepse nuk u votuan osedakorduan në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.
Implikimi politik	Implikon një zotim politik	Implikon një zotim politik	Nuk implikon një zotim politik. Kjo është arsyeja pse një rezolutë e fokusuar tek fëmijët pa përkujdesje prindërore ishte e nevojshme. Një zotim nga qeveritë për grupin tonë të synuar ishte i domosdoshëm për t'i motivuar ata të zbatojnë Udhëzimet në nivel kombëtar.
Detyrimet	E detyron shtetin të ndërmarrë veprime për të miratuar/ndryshuar ligjet dhe politikat e tyre të brendshme, raporton dhe monitoron përparimet	Nuk është juridikisht detyruese.	Nuk e obligon shtetin të ndërmarrë ndonjë veprim
Implikimet indirekte		Mund të shërbejë si burim për zhvillimin e ligjit të zakonshëm (ligjet e miratuara nga përdorimi i tyre ose ndryshimet në ligj për shkak të zbatimit në praktikë) Disa gjykata në vendet që nuk ratifikojnë traktate, shikojnë praktikën e së drejtës zakonore të vendeve të tjera kur marrin vendime në lidhje me të drejtat e njeriut	Megjithatë Udhëzimet nuk paraqesin detyrime ligjore ose politike. Ato janë të njohura në të tërë botën si standard për të gjitha praktikën që lidhen me fëmijët pa përkujdesje prindërore. Udhëzimet përmenden në këtë rezolutë në disa raste, të cilat do të kenë një ndikim në avancimin e njohjes dhe zbatimit të tyre nga qeveritë.
Hierarkia e rëndësisë	Ligj i vështirë/Rëndësi dhe kuptim të fortë	Ligj i butë por peshë e fortë përfaqësuese dhe mekanizëm i përgjegjësisë nga kolegët ndaj kolegëve	Udhëzime opsionale

Tabela 2 - Si mundet SOS potencialisht të përdorë paragrafët kryesorë?³

<p><i>Duke shprehur shqetësimin se miliona fëmijë në të gjithë botën vazhdojnë të rriten të privuar nga kujdesi prindëror, të ndarë nga familjet e tyre për shumë arsye, përfshirë por jo të kufizuar në varfëri, diskriminim, dhunë, abuzim, neglizhencë, trafikim personash, emergjenca humanitare, konflikt të armatosur, katastrofë natyrore, ndryshime klimatike, migracion, vdekje ose sëmundje të një prindi dhe mungesë qasjeje në arsim, shëndet dhe shërbime tjera për mbështetje të familjes.</i></p>	
<p>Kuptimi: Njohja e temave kryesore të lidhura me zhvillimin si shkaqe thelbësore të ndarjes së familjes</p> <p>Duke shprehur shqetësim, ata deklarojnë një angazhim të parë për të fokusuar më shumë temën duke theksuar se është diçka që kërkon veprimtë matur.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ngrit vetëdijen për lidhjen ndërmjet temave të zhvillimit dhe humbjes së kujdesit. ➤ Kontekstualizon punën tonë dhe ndërton narrativën lidhje me këto çështje të zhvillimit. ➤ Ofron bashkëpunim dhe apelon për vendimmarrësit dhe politikë-bërësit që së bashku të ndërmarrin përpjekje me ekspertizën tonë. Përdoret si kontekst për të krijuar partneritete strategjike me organizatat shumëpalëshe dhe shoqërinë civile <ul style="list-style-type: none"> • Fshehur në publikim të dukshëm • Publikimi Lë të Jenë Fëmijët Fëmijë • Dokumenti i politikave për ndryshimin klimatik nga të drejtat e fëmijëve tani! iniciativë
<p><i>Duke kujtuar rezolutën e saj 64/142 të 18 dhjetorit 2009, e cila përmbante Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve në shtojcë e saj, të cilat shërbejnë si një varg i orientimeve për të ndihmuar në informimin e politikave dhe praktikave për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror ose që janë në rrezik për të qenë të tillë, dhe njohjen e progresit që është arritur që nga miratimi i saj;</i></p>	
<p>Kuptimi: Qeveritë theksojnë vlerën e Udhëzimeve si udhëzime për zhvillimin e politikave dhe praktikave që kanë të bëjnë me kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ngrit ndërgjegjësimin për Udhëzimet dhe i promovon ato si standard për të udhëzuar qeveritë dhe ofruesit e kujdesit në planifikimin e shërbimeve të kujdesit. ➤ Siguron zbatimin e Udhëzimeve duke promovuar mjete dhe ekspertizë siç është manuali i zbatimit, dhe TPI. ➤ Avokon për cilësi në përkujdesjen alternative dhe mbështet Udhëzimet Kombeve të Bashkuara në broshurën e SOS-it për zbatimin e manualit MOOC <ul style="list-style-type: none"> • Kurs masiv online i hapur (MOOC) për Udhëzimet për Përkujdesje Alternative të Fëmijëve • Ndjekja e Iniciativës së Progresit • Duke ecur përpara: Manuali i zbatimit

³Ky është një draft që synon të përfundojë në diskutim me kolegë të ndryshëm dhe për të mbështetur të menduarit dhe planifikimin

PO21 Kujton se Konventa për të Drejtat e Fëmijës pranon që një fëmijë, për zhvillimin e plotë dhe harmonik të personalitetit dhe potencialit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar dhe se një fëmijë i privuar përkohësisht ose përgjithmonë nga ambienti i tij familjar, ose në interesin më të mirë të të cilit nuk mund të lejohet të mbetet në atë mjedis, do të ketë të drejtë për mbrojtje dhe ndihmë të veçantë të dhënë nga shteti, dhe që shtetet palë, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare dhe detyrimet e tyre sipas instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, për të siguruar kujdes të sigurt dhe të duhur cilësor për një fëmijë të tillë;

Kuptimi:

Njohja e fëmijëve pa përkujdesje prindërore si subjekt i të drejtave dhe diskutimi për çështjet alternative si të drejtat e fëmijëve, si dhe çështja e mbrojtjes së fëmijëve

Thekson rëndësinë e edukimit të familjes;

Pranimi se ndarja nga familja është në raste specifike në interesin më të mirë të fëmijës

Parimi i përshtatshmërisë. Njohja e detyrimit për të siguruar një përkujdesje alternative cilësore për fëmijët pa përkujdesje prindërore

Përdorimi dhe burimet

- Avokon për detyrimin për të krijuar të gjitha elementët për mekanizmat dhe sistemet mbrojtëse që funksionojnë mirë për fëmijët pa përkujdesje prindërore, duke përfshirë por jo të kufizuar në përkujdesjen alternative.
- Ky paragraf na ndihmon të pozicionojmë grupin tonë të synuar në diskutimet e bazuara në të drejtat;
- Diversifikon programet tona për të siguruar se qeveria mund të llogarisë me forma të ndryshme të kujdesit për të përmbushur nevojën e përshtatshmërisë së çdo fëmije.
- Forcon markën tonë duke përdorur lidhjen me CRC për të kontekstualizuar më mirë punën tonë nga perspektiva e një organizate për të drejtat e fëmijëve.
- Lobon që qeveritë të rrisin alokimet e tyre për sistemin e mbrojtjes sociale dhe posaçërisht për fëmijët pa përkujdesje prindërore përmes subvencioneve.

[Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#)

PO22 U bën thirrje të gjitha shteteve palë që të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të përmbushur detyrimet e tyre sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës për të ruajtur identitetin e fëmijëve, përfshirë kombësinë, emrin dhe marrëdhëniet e tyre familjare, siç njihet me ligj, për të mbrojtur fëmijët në çështjet që lidhen me në regjistrimin e lindjes, marrëdhëniet familjare dhe birësimin ose forma të tjera të përkujdesjes alternative, duke pranuar që çdo përpjekje duhet të drejtohet për t'i mundësuar fëmijëve të qëndrojnë ose të kthehen shpejt në kujdesin e prindërve të tyre ose, kur është e përshtatshme, të anëtarëve të tjerë të ngushtë të familjes dhe se, kur është e nevojshme kujdesi alternativ, kujdesi për familjen dhe komunitetin duhet të promovohet gjatë vendosjes në institucione;

Kuptimi:

Parandalimi i ndarjes së familjes dhe rëndësia e marrëdhënieve familjare.

Promovon përkujdesjen familjare dhe asaj me bazë në komunitet tek institucionet.

Bashkimi familjar duhet të adresohet dhe mbështetet

Përdorimi dhe burimet

- Mbështet gjyqësorin dhe autoritetet tjera në procesin e vendimmarrjes në lidhje me ribashkimin. Materializon bashkimin familjar dhe ri-integrimin në programet tona.
- Avokon për regjistrimin universal të lindjes.
- Promovon dhe zgjeron programet tona për forcimin e familjes.
- Motivon qeverinë dhe donatorët tjerë për të investuar më shumë në përkujdesjen familjare dhe atë me bazë në komunitet.

PO23 Kujton se Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kërkon që të gjitha shtetet palë të sigurojnë gëzimin e plotë nga fëmijët me aftësi të kufizuara të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mbi baza të barabarta me fëmijët e tjerë, përfshirë edhe në lidhje me jetën familjare;

Kuptimi

Njohja e dobësive të veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe barazisë së të drejtave të tyre.

Përdorimi dhe burimet

- Përmirëson programet tona ekzistuese për të siguruar që të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në to mbështeten.
- Merr parasysh ndërveprimet e aftësive të kufizuara kur planifikohen programet dhe shërbimet tona.

PO24 Ripohon që fëmijët nuk do të ndahen nga prindërit e tyre kundër vullnetit të tyre, përveç kur autoritetet kompetente, pas rishikimit gjyqësor, përcaktojnë në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi, se një ndarje e tillë është e nevojshme për interesat më të mira të fëmijës, dhe se përcaktimi i tillë mund të jetë i domosdoshme në një rast të veçantë siç është abuzimi ose neglizhimi i fëmijës nga prindërit, ose në një rast kur prindërit jetojnë veç e veç dhe duhet të merret një vendim për vendbanimin e fëmijës;

Kuptimi

Nevoja për një autoritet kompetent që të përfshihet në procesin e ndarjes.
Parimi i domosdoshmërisë
Faktorët që mund të justifikojnë rastet e ndarjes.

Përdorimi dhe burimet

- Avokon për forcimin dhe caktimin e burimeve të mjaftueshme për sistemet gjyqësore/mbrojtëse. Mbledh fonde për projekte për të mbështetur qeveritë në përcaktimin e ligjeve dhe proceseve mbrojtëse
- Mbështet dhe krijon partneritet me qeverinë në ndërtimin e aftësive për përcaktimin e interesave më të mirë të fëmijës.

PO25 Ripohon që një fëmijë nuk do të privohet nga liria e tij në mënyrë të paligjshme ose arbitrare dhe se arrestimi, ndalimi ose burgosja e një fëmije do të jetë në përputhje me ligjin dhe do të përdoret vetëm si masë e mjetit të fundit dhe për periudhën më të shkurtër të përshtatshme, dhe që çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet me humanitet dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të qenies njerëzore, dhe në një mënyrë e cila merr parasysh nevojat e personave të moshës së tij;

Kuptimi

Nevoja për një proces të rregullt në rastet që kanë të bëjnë me sektorin e drejtësisë dhe migracionit duke nënvizuar që paraburgimi duhet të përdoret vetëm si mjet i fundit.

Përdorimi dhe burimet

- Krijon partneritet me qeverinë për të ofruar shërbime të përkujdesjes dhe ndihmës për të adresuar nevojat e fëmijëve në kontekstin e drejtësisë për të mitur dhe migracionin.
- Ndërton narracion rreth sistemeve të përkujdesje alternative cilësore, si një alternative për respektimin e të drejtave të ndalimit në rastet e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë

PO26 Vëren se fëmijët pa përkujdesje prindërore kanë më shumë të ngjarë se moshatarët e tyre të pësojnë shkelje të të drejtave të njeriut, të tilla si përjashtimi, dhuna, abuzimi, neglizhenca dheshfrytëzimi, dhe në këtë drejtim shpreh shqetësim të thellë për dëmin e mundshëm të institucionalizimit dhe kujdesit institucional për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve;

Kuptimi

Përdorimi dhe burimet

- Krijon partneritet me qeveritë për të zhvilluar strategji dhe plane për de-institucionalizim, kujdes të bazuar në komunitet dhe zhvillim të shërbimeve të FS.

<p>Njohja e situatës shtesë të cenusshmërisë dhe rrezikut të shkeljes së të drejtave të fëmijëve pa përkujdesje prindërore Efektet negative të kujdesit institucional tek fëmijët</p>	<ul style="list-style-type: none"> Metodologjitë e planifikimit të DI dhe njohuritë. Metodologjitë e vlerësimit të nevojave dhe planifikimit të shërbimeve. SOS ekspertiza.
---	--

PO27 Njeh se shumë fëmijë që jetojnë pa përkujdesje prindërore kanë familje, përfshirë të paktën një prind të gjallë dhe/ose të afërm, dhe në këtë drejtim inkurajon veprimet për të arritur bashkimin familjar, përveç nëse nuk është në interesin më të mirë të fëmijës;

<p>Kuptimi Shumica e fëmijëve që jetojnë në përkujdesje kanë prindër dhe shumë prej tyre mund dhe duhet të ri-integrohen në familjet e tyre, kur është në interesin më të mirë të fëmijës.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Avokon për të bërë rishikimet eçështjeve një praktikë të qëndrueshme gjatë procesit të planifikimit të kujdesit, ndihmës për familjet për materializimin e ri-integritit kur është e mundur. ➤ Mbledh fonde për SOS-in që ofron shërbime të FS dhe mbështetje dhe trajnim të fuqisë punëtore sociale. ➤ Avokon për ta bërë pjesëmarrjen e fëmijëve një praktikë të rregullt në proceset e shqyrtimit të çështjeve dhe vendimmarrjen në kohë. ➤ Përmirëson programet tona për të përfshirë mundësinë rigorozë dhe sistematike për vlerësimin e ribashkimit <ul style="list-style-type: none"> • Instrumentet e menaxhimit të çështjeve përfshirë metodologjitë e vlerësimit të nevojave familjare.
---	--

PO28 Thekson se asnjë fëmijë nuk duhet të detyrohet të heqë dorë nga lidhjet familjare për të shpëtuar nga varfëria, ose të marrë kujdes gjithëpërfshirës, në kohë dhe shërbime shëndetësore cilësore ose arsim, ose sepse ato janë në kontakt me ligjin;

<p>Kuptimi Varfëria nuk është kurrë një arsye për ndarjen e familjes. Kontakti me Las nuk duhet të nënkuptojë kurrë ndarje nga familjet e tyre për fëmijët.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofron shërbime të FS që përqendrohen në mbështetjen e familjeve për t'u larguar nga varfëria ➤ Avokon për sisteme të forta të mbrojtjes sociale për të parandaluar ndarjen e familjes ➤ Avokon për mënyra inovative për të hyrë në arsim dhe të drejtat e shërbimeve shëndetësore për fëmijët. <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i shërbimit SOS FS dhe metodologjitë e vlerësimit të nevojave familjare. • Metodologjitë e trajnimit të aftësive prindërore. • Ekspertizë SOS në FS dhe arsim.
--	---

PO29 Njeh se varfëria, të gjitha format e dhunës, përfshirë dhunën mendore dhe fizike, dhunën në familje, dhunën strukturore dhe aktivitetet e mbijetesës mund t'i çojnë fëmijët në sistemin e drejtësisë penale, përfshirë sistemin e drejtësisë për të mitur, dhe se paraburgimi në sistemin e drejtësisë penale ndonjëherë përdoret si zëvendësim për parandalimin dhe referimin tek autoritetet dhe shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve;

<p>Kuptimi Shtetet anëtare njohin lidhjen ndërmjetvarfërisë, dhunës dhe krimit të kryer nga dhe kundër fëmijëve. Dhe ai sistem i drejtësisë për të mitur shpesh përdoret në vend të</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Avokon me qeveritë për rritjen e fokusimit në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndihmës familjare në mënyrë që të parandalojë krimin dhe VAC. ➤ Ofron metodologji për hartimin e programeve për të adresuar VAC në ambiente të ndryshme.
--	--

<p>mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve të ndihmës familjare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia e SOS-it kundër ngacmimit • Metodologjitë eSOS-ite të qenit prindër pozitiv dhe trajnimet dhe materialet pasuese • Kujdesi i informuar për traumën.
---	--

PO30 Gjithashtu pranon se varfëria financiare dhe materiale, ose kushtet direkte dhe unike të prekshme nga një varfëri e tillë, kurrë nuk duhet të jetë justifikimi vetëm për largimin e një fëmije nga kujdesi i prindërve të tij ose kujdestarëve parësor dhe kujdestarëve ligjorë, për marrjen e një përkujdesjealternative ose për parandalimin e ri-integrimit të tij, por duhet të shihet si një sinjal për nevojën për të siguruar mbështetje të përshtatshme për familjen e tyre, që fëmija përfiton drejtpërsëdrejti

<p>Kuptimi Shtetet kurrë nuk duhet të lejojnë largimin e fëmijëve nga prindërit vetëm për shkak të varfërisë së familjes duke e bërë kështu esenciale programet e forcimit të familjes dhe ndërhyrjes asistuese.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Lobon për financimin e programeve dhe shërbimeve të SOS FS. ➤ Avokon për skemat e ndihmës sociale të drejtuara ndaj fëmijëve dhe skemat e ndihmës pa para për familjet në nevojë/varfëri.
---	--

PO31 U kërkon shteteve të forcojnë sistemet e mirëqenies së fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të përmirësojnë përpjekjet për reformën e kujdesit, i cili duhet të përfshijë një bashkëpunim shumë-sektorial, mes të tjerash, ndërmjet mirëqenies së fëmijëve dhe sektorëve të shëndetit, arsimit dhe drejtësisë, koordinimin aktiv ndërmjet të gjitha autoriteteverelevante, sistemeve të përmirësuara ndërkufitare dhe përmirësimin e krijimit të aftësive dhe programeve trajnuese për akterët përkatëse;

<p>Kuptimi Rëndësia e qasjeve shumë-sektoriale për planifikimin dhe zbatimin e reformave të sistemit të kujdesit për fëmijët dhe mirëqenien. Bën thirrje për krijimin e kapaciteteve për të gjitha palët përkatëse si njëpjesë thelbësore e reformave.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pozicionohet si ekspert dhe partneri kryesor për ndërtimin e kapaciteteve qeveritare dhe autoriteteve të tjera për mbrojtjen e fëmijëve ➤ Pozicionon dhe përshkruan programet tona në një mënyrë të kontekstualizuar dhe të drejtat dhe sistemin e ngulitur për t'u bërë një pjesë e rëndësishme në përpjekjet e qeverisë
---	--

PO32 Shpreh shqetësim të thellë në lidhje me numrin e madh dhe në rritje të fëmijëve emigrantë, veçanërisht ata që janë të pashoqëruar ose të ndarë nga prindërit e tyre ose kujdestarët parësor, të cilët mund të jenë veçanërisht të prekshëm gjatë udhëtimit të tyre, dhe shpreh angazhimin për të mbrojtur të drejtat e njeriut të fëmijëve emigrantë, duke pasur parasysh cenueshmërinë e tyre, veçanërisht fëmijëve emigrantë të pashoqëruar dhe fëmijëve emigrantë me aftësi të kufizuara, për të siguruar që ata të marrin mbrojtje dhe ndihmë të përshtatshme dhe të sigurojnë shëndetin, arsimin dhe zhvillimin psikosocial të tyre, duke siguruar që interesat më të mira të fëmijësjanë konsideratë parësore në politikat për integrimin, kthimin dhe bashkimin e familjes;

<p>Kuptimi Fëmijët emigrantë si mbajtës të të drejtave të barabarta. Qasja në shërbimet themelore në baza të barabarta dhe plotësimi i nevojave të tyre psikosociale, shëndetësore dhe arsimore.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Krijon partneritet me qeveritë në zhvillimin e shërbimeve të nevojshme mbështetëse duke përdorur SOS përvojën globale për të punuar me fëmijë emigrantë, përfshirë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë. ➤ Ndërton partneritete me akterët e tjerë të shoqërisë civile për të mbrojtur ofrimin e shërbimeve për grupet e fëmijëve emigrantë të cenueshëm dhe familjet e tyre.
---	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtja e shërbimit të SOS-it dhe përvoja në ofrimin e shërbimit për fëmijët emigrantë dhe të miturve të pashoqëruar nga LAAM, EUNA dhe EUCB. • Metodologjitë e ndihmës psikosociale për fëmijët e zhvendosur dhe emigrantë • Fletë pune për refugjatët dhe fëmijët emigrantë
--	--

PO34 U kërkon shteteve të ndërmarrin veprime efektive për të siguruar mbështetje për familjet dhe për të parandaluar ndarjen e panevojshme të fëmijëve nga prindërit e tyre, përfshirë nga:

<p>Kuptimi Parandalimi i ndarjes së familjes. Përcakton kornizën për veprimet e cekura në nën-paragrafët më poshtë</p>	Përdorimi dhe burimet
---	-----------------------

PO34 a) Cakton me prioritet investimet në shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimet sociale për të mbështetur përkujdesjen alternative cilësore, përfshirë familjet dhe komunitetet për të parandaluar ndarjen e fëmijëve nga familjet e tyre, me interesat më të mira të fëmijës si çështje parësore;

<p>Kuptimi Cakton me prioritet investimet në rritjen e efektivitetit të shërbimeve, përfshirë shërbimet e mbrojtjes dhe ndihmës sociale, dhe përkujdesjen cilësore alternative.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Avokon tek qeveritë për të rritur alokimin e tyre për përkujdesjen alternative dhe mbrojtjen e fëmijëve. ➤ Mbledh fonde për programet e përkujdesjes alternative cilësore <ul style="list-style-type: none"> • Manualët e forcimit të familjes, përshkrimet e programit • Vegla pune AF7.3 • Kthimi social i investimeve
--	---

PO34 b) Miraton dhe zbaton ligje dhe përmirëson zbatimin e politikave dhe programeve, alokimin e buxhetit dhe burimeve njerëzore për të mbështetur fëmijët, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe fëmijët që jetojnë në familje të pafavorizuara, të stigmatizuara dhe të marginalizuara, për të adresuar shkaqet thelbësore të ndarjes së panevojshme të familjes dhe për të siguruar që ata kujdesen në mënyrë efektive nga familjet e tyre dhe komunitetet;

<p>Kuptimi Ky paragraf thekson elementet e një programi sistematik, duke përfshirë burimet njerëzore për të adresuar shkaqet thelbësore të ndarjes së familjes dhe rregullimit të kësaj.</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Avokon për ndryshime në legjisllacion për të përmirësuar efektivitetin e programeve, për të rritur investimet publike, për të rritur numrin e profesionistëve dhe trajnimin e tyre të vazhdueshëm. ➤ Merr në konsideratë shkaqet thelbësore të ndarjes së familjes dhe aspektet e mundshme ndër-sektoriale në hartimin dhe ekzekutimin e programeve dhe shërbimeve tona. ➤ Lobon për subvencione qeveritare në përputhje me veprimet e avokimit për rritjen e buxhetit. <ul style="list-style-type: none"> • Njëjtë si mësipër.
---	---

PO34 c) Merr të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, sociale dhe edukative për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, dëmtimi ose abuzimi, neglizhenca ose trajtimi nga pakujdesia, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, ndërsa janë në kujdesin e prindit(ërve), kujdestarit(ëve) ligjor ose ndonjë person tjetër që ka kujdesin e fëmijës;

<p>Kuptimi Ky paragraf ju bën thirrje shteteve për të promovuar mbrojtjen e fëmijëve dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj fëmijëve ndërsa janë në shtëpi, në familje ose përkujdesje alternative</p>	<p>Përdorimi dhe burimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Avokon për forcimin e procedurave të mbrojtjes së fëmijëve ➤ Manuali i procedurave të mbrojtjes së fëmijëve
<p><i>PO34 d) Njeh të drejtën së një fëmije që është vendosur nga autoritetet kompetente për qëllime të kujdesit, mbrojtjes ose trajtimit të shëndetit të tij fizik ose mendor, për një rishikim periodik të trajtimit të dhënë fëmijës dhe të gjitha rrethanave të tjera të rëndësishme të vendosjes së tij;</i></p>	
